

KOSOVARJA

Ballina: Mërgime e Xhem Aliu

**Kosova
do të mbetet veç
me pushtetarë
e farefisn e tyre**

**Si u mbajt
11 vjet rob
Zeqë Bislmi
në Serbi**

**Jemi bërë
popull që
veç ankohemi
e kritikojmë**

***Mërgime e Xhem Aliu
çifti më i famshëm
i rrjeteve sociale***

**Kush po
e vjedhë
Agnesa
Vuthajn**

**Kosova,
maden
i vajzave
të bukura**

**Xhavit Sadiku,
një jetë me këngë
të suksesshme**

**Cilët janë
konsumuesit
e gjërave
të këqija
në estradë**

remos

DENTFIX

HELPER
GENÈVE

SHERWOOD

MARITIM

allure

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

MOLLA

Shkenda Dybeni

eurokoha

BREZOVICA

CIMA



**MAGJISTRALJA PRISHTINË - FERIZAJ,
KONJUH 14000 LIPJAN**

+383 49 566 667 / WWW.DINO-COMPANY.COM

f DINO QERAMIKA



Sa kohë iu dashtë **Ledri Vulës** *që t'ia fitojë* **zemrën** **Sara Hoxhës?**

Ledri Vula ka treguar si është njohur me partneren e tij, Sarën, me të cilën janë prindër të një vajze, Poem Blue. Ai u shpreh se janë njohur në një koncert të tij në Gjermani, por Sara nuk e njihnte dhe më pas i ishte dashur një vit mundim që të mund të takohej me të. "Me Sarën jam njoftë krejt rastësisht, me një koncert në Gjermani, ku shoqet e Sarës kanë ardhur me më pa live dhe Sara s'më ka njoft. M'i ka dit

këngët, por se ka dit se kush jam. Ka ardhur me shoqe me bo foto, por më ka pëlqyer Sara, ndoshta se s'ja ka ni për mu dhe, pastaj, kështu kemi fillu, duke fol. Dhe, për herë të parë e kam takuar në Shqipëri. Një vit ma ka shty, më ka munduar derisa e kam takua, por publike është bërë, na kanë parë njerëzit bashkë, na kanë bërë video", thotë Ledri.



Albërije Hadërgjonaj **10 mijë euro** **për një dasmë!**

Albërije Hadërgjonaj tashmë është shpërngulur te vajzat në SHBA dhe po jetojnë të gjitha bashkë. Vajza e Albërijës, Anxhelina, ka një raport miqësor të ngushtë me grimirin dhe mikun e familjes Kardashian, Ariel. Vlen të përmendim se dy vite më parë, kur Anxhelina u rikthye në muzikë pas 9 vitesh mungesë me një këngë të re, Kim Kardashian e mbështeti publikisht.

Por, t'i kthehemi Albërijës. Edhe pse, zakonisht, artistët nuk dëshirojnë të flasin me shifra dhe të tregojnë rreth pagesave të tyre Por, Albërija nuk ngurroi të tregonte se për një performancë në një dasmë kërkon deri 8-10 mijë euro. "Me orkestrë shkoj nga 8 deri në 10 mijë euro. Ndaj jam bërë edhe selektive me performancat", thotë ajo. Andaj, sivjet është verë e majme për Albërijën, a?!

Pse sot nuk të vjen kush as për Bajram?

Vera ishte gëzimi më i madh si fëmijë. E, pse – dihej... Luanim ne, fëmija, në mbrëmje deri vonë, sepse qielli i kthjelltë nuk e linte të binte errësira mbi tokë deri vonë... Unë isha fëmijë kureshtar: zgjohesha shumë herët që të shihja a ishte ditë e mirë a e vrtetë. Sepse, në mbrëmje na priste loja...

Xha Raifi, fqinj imi, në burgun e Sremit i kishte mbajtur 12 vjet burg politik. Ai tregonte si dukej vera në oborrin e burgut...

Këtë e kisha dëgjuar shumë herë prej tij, sepse sa herë që na vinte ndokush mysafir, pas darke vinte gjithmonë xha Raifi... Një mbrëmje, teksa luanim me fëmijë fshehtazi pa duajve të tallës dhe stogjeve me sanë, dëgjova që dikush në dyert e oborrit trokiste.

Si fëmijë kureshtar, shpejt e shpejt vrapova dhe e hapa derën. Ishte një njeri që e kërkonte tim babë. Vrapova dhe i tregova. Ai doli menjëherë pas meje në oborr.

Nga biseda pash se ishte xha Imeri, nga Plitkoviqi, të cilit jo larg shtëpisë sonë i ishte thyer rrota e qerres së drunjtë, mu te muri i shtëpisë së xha Raifit.

Babai doli t'i ndihmonte xha Imerit, i cili rrinte pranë qerres së thyer. Për ta vënë rrotën duhej zbarkuar drutë. Tutje, të qohet qerrja e të vendosej rrota, e tek pastaj të ngarkoheshin drutë në qerre.

Dhe, teksa mundoheshin ta rregullonin qerren e thyer, një zotëri, flokët përpjetë e të paluara mirë, iu turrë babës ta lëshonte rrugën...

"Ta lëshosh rrugën menjëherë!", bërtiti ai. Babai, si i urtë që ishte, nuk dukej i tillë



edhe në shpirt nëse e prekje në sedër. E shikoi zotërinë faqekuq që ishte me veturë "Fiat 1300", që ishin shumë të rrallë dhe i tha se ishte duke e ndihmuar drush-itësin, që ta lironte rrugën. Por, zotëria faqekuq, nuk tërhiqej nga ideja se rruga duhej të lirohej menjëherë... Babai u mundua t'i shpjegonte se krejt kjo punë nuk mbaronte pa, të paktën, një orë punë. I tha të hynte në odë se kishte edhe të tjerë në të dhe të pinte çaj, derisa ta aftësonte qerren e plakut.

A E DI KUSH JAM UNË, BRE?!

Por, kur zotëria faqekuq i tha babës se a di kush jam unë, babai u ndalë dhe i bërtiti: "E di kush je! Ti je bërlllok!".

Dhe, tek i tha ato fjalë, kapi një dru në qerre dhe ia mëshoi faqekuqit në shpinë. Ai nisi të bërtasë dhe deshi të ikte, por babai e detyroi të rrijë aty, madje edhe t'u ndihmojë në largimin e qerres...

Në mbrëmje u mbush oda mysafirë. Shumë prej tyre nuk i njihja. E njihja Hasanin, nga Bellanica e Podrimjes. E njihja Ajetin, nga Vërmica kufitare dhe disa të tjerë me do kofinë prej thuprave të shelgut, që, me gjasë, kishin armë. Nata ishte e pabesë nga ajo që kishte ndodhur gjatë ditës. Dy vetë do ruanin natën jashtë: te therrat dhe njëri te shtegu i rrugës, që drejtohej kah oda.

Burrat tjerë pinin çaj në odë...

Por, nuk vonoi shumë dhe një "gazikë" e policisë me disa policë në të erdhën para derës së oborrit tonë. Me ta ishte edhe ai, faqekuqi, të cilit babai ia kishte dhënë një dru të majmë.

Dhe, pa një e pa dy policët dolën nga "gazika". E, kur faqekuqi ua bëri me kokë në drejtim të babait, ata, sa mbyllë e hapë sytë e rrethuan.

Por, babai nuk dorëzohej dot. U tha se i ka rënë dru dhe do t'i bij sërish, sa herë që ta lyp, siç e lypi sot...

Dhe, po të mos ishte njëri nga policët mik i xha Raifit, babai nuk do të kishte shpëtuar pa naj ditë në burg...

NUK TË VJEN KUSH AS PËR BAJRAM!

Dhe, t'i kthehem titullit të këtij shkrimi...

Atëherë, në fëmijërinë time, oda e tim babai ishte plot burra, verë e dimër, siç thuhet. E, sot nuk të vjen kush as për Bajram!

Se është kështu, të shtunën që shkoi ishte ditë Bajrami. Binte një shi i imtë. Ishte ftohtë për këtë kohë vere... Ndoshta mu shkaku i kohës së keqe edhe shkuarje-ardhjet për festën e Bajramit qenë shumë të vogla, për të mos thënë fare...

Pse ndodh kjo? Pse po largohemi nga njëri-tjetri?

S. Murturi

Kosova, *maden* *i vajzave* *të bukura!*

Me ardhjen e shatcave në Kosovë, gjallëria në rrugët e Prishtinës, por edhe të qyteteve të tjera të Kosovës shtohet aq shumë sa njeriu s'ka kah kalon prej veturave, shumica e të cilave janë luksoze.

Valushi, djalë rreth të 30-ave, ka tri javë që është në Kosovë, konkretisht në Gjilan. Ai jeton ë Zvicër. Atje ku jeton ai, në Basel, thotë se nuk sheh njerëz në rrugë, veç atyre që vrapojnë për në punë. E këtu, në Gjilan, por edhe në Prishtinë, rrugët janë të mbushura me njerëz, qoftë gjatë ditës, qoftë gjatë mbrëmjes, por edhe në orët e vona të natës. Ai thotë se i kënaqet zemra kur sheh kudo me bollëk vajza të reja, të bukura, engjëllushe...

SHQIPTARËT - ME PLAKA GJERMANE PËR DORE!

"Atje ku jetoj unë, në Basel të Zvicrës, të merr malli të shohësh vajza të reja, të bukura. Kudo sheh plaka, me rrudha të mëdha në fytyrë e qafë, me

ndonjë djalë për dore. Ata janë, kryesisht, të rinj nga vende të ndryshme të botës... Kryesisht shqiptarë, kurdë, sirianë e të tjerë, që kanë ardhur të gjejnë strehim në Zvicër. Dhe, për të ardhur deri të leje qëndrimi, lidhen me plaka sa për të pasur ku të strehohen. Kjo është njësoj si vajzat tona që lidhen me huajt që ndodhen në Kosovë. Por, në një gjë jam i sigurt: vajzat shqiptare nuk rrëzohen lehtë siç rrëzohen të huajat..

EVROPA ËSHTË ZERO KARSHI KOSOVËS!

"Në Kosovë, në cilindo qytet të saj, e edhe në katunde kudo ka vajza të bukura, të cilat nuk t'i zë syri as në Zvicër, as në Gjermani ku kam qenë disa herë,

e as në Belgjikë. Kudo nëpër lokale e klube të ndryshme vezullojnë femrat me bukurinë e tyre, atmosferë që nuk e gjejmë as në vendet më të zhvilluara të Evropës. "Vërtet, këtu, në Kosovë, asgjë nuk mungon. Por, një gjë duhet theksuar, femra të bukura si në Kosovë askund s'ka. Kosova është maden i femrave të bukura dhe populli i Kosovës duhet të krenohet me këtë gjë", shpreh bindjen e tij Valush Hajdini, nga Gjilani. Por, nuk është vetëm Valushi që ka bindje të mirë për vajzat e Kosovës. Njëjtë mendon edhe Daorti dhe Mentori, e që të dy jetojnë në Pellsilvani të Amerikës, e që në Kosovë janë që një javë, ku do të qëndrojnë edhe dy javë të tjera. Të dy janë me prejardhje nga Prishtina.

Selim Rama

Pse s'u besojmë as politikanëve e as gazetarëve?



Politikanët shumë premtojnë e pak realizojnë! E, gazetarët janë të ndarë sipas përcaktimeve politike. Këto dy gjëra ndikojnë te pjesa më e madhe e njerëzve që nuk u besojnë as politikanëve e as gazetarëve. Se është kështu flasin edhe të anketuarit tanë...

ERNESTI, STUDENT I FILOZOFIKUT:

- Hë? Anketë shumë me vend. Sepse, i përshtatet kohës. Sa u përket politikanëve, mendoj se shumë pak ka mbetur t'u besohet, sidomos deputetëve tanë. Sepse, para se të bëhen deputet premtojnë shumë, e kur të zgjidhen deputet as në mbledhjet e parlamentit nuk shkojnë!

E, njëjtë është puna edhe me gazetarët. Secili shkruan sipas orientimit të tij politik! Secili çon ujë në mullirin e partisë që e favorizon. Sepse, gazetarë hakikat ka pak, për të mos thënë fare...

MIRANDA, PUNËTORE NË BUTIK

- Fjalë sa të duash e punë pak. Kjo vlen për politikanët tanë. Sepse, në kohën e zgjedhjeve premtojnë e premtojnë, e kur ta arrijnë karrigen i fusin veshtë në lesh dhe bëhen sikur

nuk dëgjojnë..

E, për gazetarët s'di ç'të them. Disa gazetarë mendoj se shkruajnë mirë, mirëpo nuk u besoj edhe aq.

SHPRESA, PUNËTORE ADMINISTRATE

- Politikanëve u besoj, sepse edhe vetë punoj me ta. Mundohen, por ndryshimi i gjërave nuk arrihet nga një person, por nga të gjithë bashkë. E, të gjithë bashkë te ne në Kosovë s'ka shans me i bë, sepse jemi shumë parti politike dhe gjithsecili angazhohet për interesin e partisë së vet.

E, gazetarët i lus që kur të shkruajnë për ndonjë ngjarje të bazohen në fakte, t'i citojnë burimet ku i kanë marrë e jo të shkruajnë sipas tekeve të tyre.

Sidomos në disa portale gjejmë shkrime që nuk kanë të bëjnë asgjë me të vërtetën dhe pa fije turpi vazhdojnë me të tyren!

ARBËRI, GAZETAR NË RADIO


- Temë shumë e qëlluar dhe, po të jesh i drejtë, nuk është vështirë të përgjigjesh. Politikanët, sidomos deputetët i kritikojmë me të madhe, sepse gjatë fushatës zgjedhore japin premtime e premtime, kurse gjatë mandatit sikur bien në gjumë... E, për ne, gazetarët s'kam çka të them, sepse nuk më takon mua ta lavdëroj punën time, por le të flasin lexuesit tuaj, e që mendoj se janë të shumtë, meqë "Kosovarja" ka numër të madh lexuesish.

PËR FUND

Politikanët tanë bëjnë çmos që të marrin poste, veçmas deputetët, e kur vijnë në pushtet më shumë merren me hallet e veta sesa me të popullit. E, gazetarë sot ka sa të duash, madje edhe pa përvojë fare! Keq, a?

N. Selim

KOSOVA DO TË MBETËT VEÇ ME PUSHTETARË E FAREFISIN E TYRE!



Kosova e lirë po zbrazet çdo ditë e më shumë. E, as vapa e kësaj vere nuk po i ndalë dot... Aeroplanët vijnë në Kosovë me udhëtarë, por kthehen edhe me më shumë udhëtarë!

E, përgjigja e të gjithëve për pse-në e ikjes nga Kosova është e njëjtë:

Nuk jetohet këtu më...

Nuk jetohet pa punë, pa bukë për fëmijë, për familje.

Nuk jetohet më në skamje, në varfëri...

Kush e ka menduar se na vjen një ditë e tillë, edhe pas 22 vjet lirie?!

Kush e ka menduar se do ta lëshojmë Kosovën në liri, për të cilën shumë sakrifikuam, brez pas brezi: të vuajtur, të shtypur, të përbuzur, të vvarë...

Përjetuam e ç'përjetuam. I përjetuam edhe ditët kur vështirë ishte të jesh shqiptar, ta mbash emrin shqiptar, ta kesh plisin në kokë...

Kush ka menduar se pushtetarët do të mendojnë e luftojnë veç për karrige të veten, për pushtet.

Dhe, pa fije turpi të ndërtojnë pallate, të shëtisin me xhipa, të pushojnë në pushimoret e vendeve më në zë bregdetare, t'i punësojnë veç të afërmit e tyre, farefisën, pa marrë parasysh aftësinë e tyre se a dinë ta kryejnë punën a jo.

Mjafton fakti, që, sipas mjekut Pleureat Sejdiu, vetëm sivjet 109 mjekë u larguan nga Kosova, e 600 të tjerë janë të papunë!

E, sa është numri i qytetarëve që e kanë lëshuar Kosovën, për të ikur nga skamja, përditshmëria e rëndë dhe kërkojnë në Perëndim jetë më të mirë, kjo nuk dihet, meqë askush nuk mban shënime!

E, në Parlament e kudo tjetër, dihet, ka veç fjalë:

Duhet të krijojmë kushte që qytetarët tanë të mos kenë arsye ta lëshojnë Kosovën...

Do të punojmë që qytetarët të mos e lëshojnë Kosovën...

Dhe, fjalë sa të duash...

E, qytetarët ikin, sepse janë ngopur me fjalë të kota!

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Mërgime e Xhem Aliu, çifti më i famshëm i rrjeteve sociale

Mr.mrs.aliu është blogu shumë i njohur në “Instagram” i çiftit Mërgime e Xhem Aliu, të cilët kanë vendosur që në këtë rrjet social të prezantojnë copëza nga jeta e tyre.

Mërgimja, femër e zgjuar, profesioniste e flokëve, e suksesshme në biznes, e pashme, elegante dhe me stil, me origjinë është nga Lugina e Preshevës, e lindur dhe e rritur në Zvicër në kantonin Sangall.

Ka biznesin e saj “Meana Hair”, punon frizere dhe ka një klientelë tejet të kënaqur. Është blogere e famshme dhe bashkëshorte e nënë e lumtur e një vajze.

E, Xhemi është njeri i jashtëzakonshëm, punëtor i pandalshëm dhe burrë që çdo situatë e merr me të lehtë. Ai është nga Saraj i Shkupit, i lindur e rritur në Zvicër në kantonin Sangall. Punon në punë shteti në “SBB” dhe publikisht njihet nga blogu Mr.mrs.aliu.

28-vjeçarët, tashmë të famshëm, kulmin e lumturisë e kanë arritur para katër vitesh, atëherë kur u bënë prindër të Tuanës, që është dashuria dhe pasuria më e madhe që kanë.

Në “Kosovare” flasin për jetën, punën dhe gjithçka rreth tyre...



Qe sa vjet jeni bashkë?

- Jemi bashkë qe njëmbëdhjetë vjet e gjysmë. Të lumtur dhe të pandarë.

Ku dhe si jeni njohur?

- Mesiti ynë ka qenë "Facebook"-u. Pra, jemi njohur dhe kemi folur përmes këtij rrjeti social.

Mërgime, çfarë mendove kur e pe Xhemin për herë të parë?

- Xhemi, fillimisht, ka qenë shumë i turpshëm, ama qesharak. Dinte të krijonte situata komike. Momentin e parë kur e kam njohur, kam thënë me vete: Sa dhëmbët e bukur!

Xhem, a mendoje se Mërgimja do të jetë bashkëshortja e nëna e fëmijëve të tu?

- Kam qenë shumë i ri, i kam pasur vetëm 17 vjet dhe nuk kam menduar shumë për të ardhmen. Por, shpejt e kam kuptuar se Mërgimja do të jetë gruaja e jetës sime dhe nëna e fëmijëve të mi.

Cili është momenti më i bukur i jetës si çift?

- Kemi shumë momente të bukura. Ishte fillimi, bashkimi ynë, pastaj ka



një mori momentesh të paharruara. Kujtojmë fejesën, martesën dhe hapat e parë në jetën tonë si çift. Gjithsesi, i paharrueshëm mbetet momenti kur u bëmë prindër për herë të parë dhe, kështu, u kompletua gjithçka.

Jeni prindër të lumtur të një vajze. Si është jeta me një fëmijë dhe me kaq shumë angazhime?

- Jeta jonë prej se jemi bërë prindër nuk mund të përshkruhet me asnjë fjalë. Çdo gjë që e bëjmë është për vajzën tonë.

Edhe familjen e kemi afër për të na mbështetur në çdo hap, edhe kur kemi më tepër angazhime për t'u përkujdesur për vajzën.

A ziheni ndonjëherë, a keni momente xhelozie dhe cili jeni më xheloz?

- Nuk ka çift që nuk zihen, madje, kush thotë kështu edhe gënjen. Unë jam më provokuese, kurse Xhemi është më "chill". Në fillim të lidhjes ka qenë Xhemi tepër xheloz, pastaj unë. Tani ka ndryshuar çdo gjë. Gjithsesi, unë nuk i them vetes që jam xheloze, thjesht e mbroj atë që është e imja (qesh).

Momenti më i sikletshëm gjatë jetës si çift?

- Janë momentet kur diskutojmë për t'i blerë diçka vajzës, e unë jam që të mos blihet çdo gjë, gjëra të kota. E, babi nuk mund t'i thotë jo për asgjë. Pa dyshim, e lazdron më tepër, ndërkaq unë jam më strikte. Vajza e pranon se babi i blen çdo gjë e mami jo.

E, këto janë momente të sikletshme, por jo të ndonjë rëndësie të madhe.

Cili jeni më romantik?

- Asnjëri. Në fillim të lidhjes ishte Xhemi, tani na mjafton, thjesht, të kemi kohë për të qenë bashkë. Të dy punojmë shumë rreth angazhimeve tona profesionale, e kemi vajzën dhe jemi të lumtur kur gjejmë kohë gjatë ditës të takohemi dhe të rrimë bashkë.

Cili i bëni dhurata më shumë?

- I japim njëri-tjetrit më shumë dhurata kur nuk ka festa, e kjo na duket më speciale. Kur bëjmë dhurata, ato janë vërtet të veçanta.

Kush falë më shumë dhe më shpesh?

- Xhemi, që është njeri me zemër të butë dhe të tillë nuk kam njohur kurrë më parë në jetën time. Unë jam impulsive, kam inat dhe kur jam gabim më shkon shumë gjatë derisa të vendos të kërkoj falje. Besoj se, ne femrat, e kemi kështu, në përgjithësi. Ne mund t'u falim burrave diçka, por prapë ua përmendim një mijë herë...

Jeni bërë të famshëm përmes blogut tuaj në "Instagram". E kujt ishte ideja?

- Ideja e askujt. Nuk e kemi pasur fare në plan të punojmë për t'u bërë të famshëm. Ka ndodhur rastësisht dhe jemi shokuar se sa shpejt janë shpërndarë videot tona. E kemi bërë video këngën "E du një vajzë shqiptare", derisa po vozitnim





dhe ajo ka marrë shumë pëlqime, edhe pse faqen e kemi pasur private. Atë ditë na ka shkruar një faqe që ishte për çifte shqiptare, duke na pyetur a mund ta postojnë videon. Ne kemi pranuar dhe nga ai moment video dhe emrat tanë kanë qenë kudo në rrjet.

Çka ju dallon nga bloggerët tjerë?

- Të gjithë kanë diçka të veçantë. E veçanta jonë është se nuk duam të prezantohemi me marka, gjëra të shtrenjta e luksoze. Këto i mbajmë për vete. Ne prezantohemi thjesht, duke u treguar të tjerëve se mund të arrijnë çka do që duan. Unë dhe Xhemi ia kemi dhënë njëri-tjetrit fjalën që të mos ndryshojmë kurrë dhe për askënd.

Pos blogut me çka merreni, cila është jeta juaj jashtë "Instagramit"?

- Xhemi punon në "Schweizerische Bundesbahn". Unë, përpos "Instagramit" e kam biznesin tim, sallonin "Meana Hair", që e kam hapur në vitin 2019 dhe ku punoj 100%. Kryej shërbime të ndryshme profesionale, si ngjyrosjen e flokëve...

Jam e specializuar për Balayage dhe shatirim, bëj prerjen e flokëve për meshkuj dhe femra dhe tani në sallon kemi hapur edhe këndin e kozmetikës. Jam prej atyre pak blogereve që edhe punoj. Kam mundur të vazhdoj vetëm me "Instagram", si të tjerët, por dëshira ime ka qenë gjithmonë që të hapë sallonin tim dhe ta kem një profesion për gjithë jetën. Gjithsesi, biznesin dhe "Instagramin" i kam shumë për zemër...

A keni ndonjë projekt së shpejti?

- Momentalisht kemi shumë projekte në sallonin tonë. Sapo t'i kryejmë do të fillojmë të merremi më shumë me "Instagramin".

Qëndroni me ne!

Nderim Neziri

ME Mérjime & Them





Pse askush nuk e viziton varrin e Shotë Galicës?

Kam ardhur tek varri i rrënuar i Shotë Galicës, në vendin e quajtur Teqja e Fushë-Krujës. E vështroj varrin sikur të jem aktor e po luaj ndonjë film dokumentar...

Për heroinën e Kosovës janë shkruar një vargmal me libra, janë realizuar filma, baletë e janë kënduar në koncerte qindra këngë... E, fati pas kaq motesh e ka braktisur. Varri është mbuluar nga ferrat, drizat, myshqet e pluhuri. Mbi pllakën e plasarit vallëzojnë një çift hardhucash. Përbri varrit, në një rrugë të verbër, lëvizin udhëtarë të vetmuar, gjahtarë të fshehtë, kositës bari, vrasës, trafikantë të drogës e njerëz që e kanë humbur rrugën. Edhe për shkak të autostradës Tiranë-Shkodër, varrin po e përthithë pylli i

ndërtimeve që çdo vit bëhet edhe më i egër.

Askush nuk e viziton më varrin e femrës më me emër në Shqipëri! E para është Shotë Galica, e pastaj renditen të tjera gra e vajza që kanë bërë histori.

Dikur vinin me dhjetëra autobusë me nxënës, si dhe turistë nga bota. Tani vetëm vajton era e maleve të Krujës dhe një shpend i zi.

Vendasit thonë se është një korbë dhe, si të jetë vajtojcë nga ato të Radishevës, mërmërin fatin e Shotë Galicës...

Qëkur pas zgjedhjeve u bë Kryeministër Fatos Nano, një grup atdhetarësh nga Prishtina, nga Galica e Azem Galicës dhe nga Radisheva, ku ka lindur Shotë Galica bënë disa kërkesa që eshtrat e Shotë Galicës të zhvarroseshin dhe, pastaj, ato të varroseshin pranë burrit të saj - Azem Galicës, në Drenicën e Pashës. Por, të gjitha kërkesat, takimet,

konsultat dhe bisedat me deputetë e njerëz të jurisprudencës përfunduan në koshin e plehrave! Herë me po, po edhe herë jo, jo.

Këshilltarët e Nanos përgjigjeshin se Shotë Galica nuk mund të zhvarrosset. E kundërshton komuniteti i kosovarëve që banojnë në Fushë-Krujë. Por, trokitjet nuk u sosën edhe kur u ndërrua pushteti i Fatos Nanos. I njëjti avaz që nga Galica e Radisheva e nëpër zyrat e shtetit shqiptar ku ndërrojnë "foletë" punonjësit e partive politike... E, kosovarëve të interesuar u thuhej tipikisht shqiptarçe se "çështjen e zhvarrimit të eshtrave të Shotë Galicës e kemi në shqyrtim".

Por, deri më sot asnjë mendje kreative dhe vizionare nuk i ka dhënë zgjidhje. Kosovarët venë e vinë dhe i përsëritin kërkesat, në trajtat më të ashpra përtej limiteve, gjersa çështja përsëri zero...

Sefer Pasha

Si u mbajt 11 vjet rob Zeqë Bislimi në Serbi?

Njeriu që siguron ekzistencën familjare nga karroca në tregun e Ferizajt, Zeqë Bislimi, i bërë qull nga shiu i asaj dite, i jepte nga xhepi centët e fundit të fitimit ditor për barëra për nipin dy javësh...



Zeqë Bislimi

Në katin e katërt të banesës 45 metra katrorë, që është shndërruar në kontest të ashpër juridik mes tij dhe Vitomir Gjorgjeviqit, ish-komandant i

stacionit policor në Shtime, si dhe oficer brutal policor serb kundër shqiptarëve të Ferizajt e më gjerë, qëndron një dry, e që dëshmon një luftë mes

Zeqë Bislimit dhe "Habitat"-it...

Storia tjetër e Zeqë Bislimit, megjithatë, është dramë më vete dhe shpalosë një pabesueshmëri të fatit që dëshmon se "rasti është mbreti i botës", pasi ai njëmbëdhjetë vjet i ka shërbyer serbit Nejdor Brajković, nga Kosanica e Serbisë.

I rrahur shumë herë nga serbët lokalë dhe i maltretuar për vdekje, Zeqë Bislimi, aktualisht 54 vjeç, për njëmbëdhjetë vjet të jetës së tij ia ka kryer të gjitha punët e shtëpisë pronarit Nejdor Brajković, nga Kosanica e Serbisë, duke punuar dhjetëra hektarë tokë dhe duke u kujdesur për mbi dhjetë krerë lopë, derra dhe çdo gjë të gjallë në shtëpinë dhe në fushën e tij.

Zeqë Bislimi, me një jetë tepër dramatike, i ka kaluar tmerrësisht edhe vitet e luftës në shtëpinë e Nejdor Brajkovićit, duke pritur se kur do të vritej, apo, të paktën, kur do të rrihej prej tij, si një njeri që mbahej peng me lejen e organeve policore dhe shtetërore të Serbisë.

Ai kishte filluar të humbasë shpresën se do të arrinte në Kosovë përsëri, pasi nuk kishte asnjë dokument identiteti për kalimin e kufirit, gjë që e bënte problemin kryesor të ikte për në vendlindjen e tij në Ferizaj.

Fati i shpëtimit të tij ishte mjekra dhe kapela tradicionale serbe, që e bartte, duke shërbyer si mbrojtje rasti.

Zeqë Bislimi ka arritur, në fund, të depërtojë në Kosovë përmes kamionëve të transportit me zall, por peripecitë e tij nuk kanë përfunduar as me t'u kthyer në Kosovë.

Përballja e tij me ligjin për banesën e

Familja mendonte se ishte zhdukur...

vetme që ka qenë pronë e nënës së tij, vazhdon në mënyrë tepër çnjerëzore dhe pa ndonjë parim human, kur ai, sikur ka ndodhur disa herë, është hedhur në rrugë me të vëllanë dhe nusen e tij, për ta sfiduar dhe kundërshtuar njohjen e pronësisë së banesës nga "Habitat"-i, në favor të kryepolicit Gjorgjeviq.

Gjatë kohës së masave të dhunshme të Serbisë, shteti serb në Kosovë i kishte lëshuar një vendim pronësie Gjorgjeviqit, kinse banesa ishte pronë e tij, vendim që respektohet edhe nga "Habitat"-i, një organizatë e instaluar pas lufte me mekanizma ekzekutivë për çështje dhe probleme banimi.

SI E SHITËN ZEQË BISLIMIN NË SERBI?

Duke folur për shitjen e tij në Serbi, Zeqë Bislimi ka treguar gjithë procesin e pabesisë ndaj tij nga, siç thotë ai, bashkëpunëtorët e Serbisë në vitin 1997, kur atij iu bë oferta të shkonte për të punuar në Serbi, në një punë ku gjoja do të preheshin dru mali. Duke shpalosur rrëfimin më të tmerrshëm të jetës së tij, ai thotë: "Nëna më ka vdekur në vitin 1986 dhe na la tre vëllezër e tri motra. Njëri vëlla ka vdekur dhe motra, Miradija, është zhdukur.

Kur na nxorën nga banesa rreth tridhjetë policë serbë, i përgjakën muret e saj, duke e rrahur më së keqi vëllanë tim, Beqën, pasi ky desh të rezistojë që të mos dilte nga banesa që na e la nëna.

Forca jonë ishte e vogël përballë policëve serbë dhe ne dolëm nga banesa, se nuk kishim shtet ta mbronim të drejtën tonë...

Unë shkova te teza në Petrovë, se nuk kisha ku ta strehoja kokën. Tre vjet qëndrova te ajo dhe disa njerëz, që nuk dua t'ua përmendi emrat, e që bashkëpunonin me Serbinë, më thanë të shkoja me ta për të punuar në Serbi...

Shkuam me veturë të markës "Vauburg", në Mala Kosanica (Kosanica e Vogël), në shtëpinë e Nejdor Brajkoviqit.

Unë nuk e dija se ata paraprakisht më kishin shitur te ai për dy mijë DM. Unë do të mbetesh aty, sepse ishte bërë marrëveshje mes tyre dhe fatit tim, që do ta përshkonte jetën time për njëmbëdhjetë vjet rresht, pa pasur guxim të dilja nga shtëpia", nis rrëfimin e tij Zeqë Bislimi, në banesën e tij në Ferizaj.

Dhe, për njëmbëdhjetë vjet të qëndrimit aty, Zeqa ka qenë i detyruar të kujdesej për bagëtinë dhe tokën e Brajkoviqit.

Sa herë ka tentuar të ikte, Zeqa ka përfunduar në duart e serbëve, kudo që është takuar prej tyre...

Rreth këtyre problemeve ai deklaroi: "Më kanë rrahur shumë herë dhe kur e lajmërova padronin tim, e ftonte policinë, e ata talleshin me mua, duke më thënë se më kishin rrahur shqip-tarët.

Kam qenë 42 vjeç kur kam dalë nga Kosova dhe ata që më sollën këtu më morën për me pre dru.

Ai që ma mori letërnjoftimin, se gjoja i duhej për të m'i rregulluar disa procedura që lidheshin me punën për prerjen e druve u zhdukë. Atë më nuk e kam parë kurrë! Nuk kam arritur ta marrë më kurrë as letërnjoftimin. Më sollën për të mos u kthyer më në Kosovë. Letërnjoftimi më duhej për lëvizje. Kur e pyeta Nejdorin ku ishte ai që ma mori letërnjoftimin, më tha se ai nuk jeton më këtu...

"Ku ma ka lënë letërnjoftimin?", e pyeta.

Nejdori ma ktheu:

"Çka të duhet ty letërnjoftimi, pasi do të qëndrosh i sigurt te unë?!"

"Duhet të ma kthej letërnjoftimin, sepse dua të kthehem në shtëpi!", i thash.

"Ti nuk mund të shkosh askund, sepse unë të kam blerë ty për 2000 DM!", ma ktheu.

"Unë nuk jam i shitur!", i thash.

"Mirë, m'i kthe paratë dhe shko!", më tha Nejdori.

Pastaj, më kërcënoi e më tha: "Vetëm provo të dalësh prej këtu dhe do të shohësh me çka do të përballësh!".

Kuptova menjëherë se puna ime ishte komplikuar dhe për mua ishte negociuar si rob, skllav i shitur.

U nisa të dalë nga shtëpia, por nuk i

bëra as pesëdhjetë hapa kur më doli para patrulla e policisë, që, si duket, më priste mua.

Më morën dhe më futën në shtëpinë e Brajkoviqit, duke më kërcënuar dhe më ulën para tij.

Filluan të pyesin se kush isha... Ai u tregonte me ton të ulur, gjoja me zemër të mirë, si një njeri që kinse po më mbronte se unë isha punëtor i tij dhe se isha njeri i mirë...

Në të kundërtën, u tha policëve, le të m'i kthej paratë dhe do më linte të lirë...

Policët, pastaj, më pyetën se a kisha para t'ia ktheja Nejdorit për të qenë unë i lirë. U thash se nuk kisha, sepse kisha ardhur për të punuar e fituar. Në fund, policët më thanë: Ose të rrija aty për të punuar, ose t'i ktheja paratë, apo do të punoja deri të thoshte Nejdori mjaft ishte...

Në të kundërtën, do më çonin në burg, ku do më mbysnin të burgosurit serbë.

Dhe, pasi mendova pak, mora vendim që të qëndroja aty për punë. Dhe, duke qenë aty, kisha ndonjë shpresë se do të arratisesha disa, nëse kisha pak fat.

Nëse shkoja në burg do ma fusnin thikën pas shpine dhe do vdisja pa e ditur askush...

Para policëve pranova të bëhesha punëtor i Brajkoviqit, duke pranuar detyrime pune, sipas urdhrat të pronarit. Punët kishin të bënin me malin, bagëtinë, fushën dhe me punët në shtëpinë e tij.

Nuk kisha menduar se do t'i kaloja aty 11 vjet "jetë", pa ditur askush nga familja se unë isha zënë rob në Serbi! Nejdor Brajkoviqi i kishte 12 krerë lopë, shumë derra, pula dhe 45 hektarë mal, e 8 hektarë tokë pune. Për çdo dimër më duhej t'i preja nga 18 rimorkio dru për shtëpinë e tij dhe të punoja tërë ditën pa ndalur kurrë, që nga ora 5 e agimit, kur të gjithë flinin.

Ishte një punë shumë e mundimshme, verë e dimër njëjtë...

Njëjtë e kisha edhe kur festonin. Vinin vajzat dhe djemtë e tij gjatë festave dhe më detyronin të pija edhe unë raki me ta, doja apo nuk doja, nuk varej nga dëshira ime...

Unë kujdesesha të mos e teproja, sepse nuk mund të zgjohesha të nesërmen me kohë, e kur ndodhte të mos zgjohesha me kohë, më rrihnin. Djemtë e mësonin Nejdorin se duhej të më jepte sa më shumë punë. Ata i jepnin këshilla babait të tyre, thuajse ai nuk dinte të më urdhëronte! Shpesh mendoja se si do të më vinte fundi te ky serb, nëse jeta dhe fati nuk më jepnin mundësi arratisjeje... Mendoja se një ditë, kur t'më lëshonte fuqia, ai do ma jepte një plumb në kokë dhe çdo gjë do të mbaronte me mua, e trupi im do të kalbej në Serbi", flet Zeqë Bislimi.

DUKE PRITUR VDEKJEN...

"Ishte viti 1998 kur në Kosovë, aq sa dëgjoja dhe kuptoja, gjendja ishte acaruar shumë", vazhdon rrëfimin Zeqa dhe shton:

"Largimi im nga ai vend dukej më i vështirë dita –ditës! Një kohë të gjatë nuk më zinte gjumi natën nga frika, sepse përgatitej luftë në Kosovë. Një fat i tillë më priste edhe mua. Ditët për mua bëheshin gjithnjë e më të vështira. Dhe, sa më shumë kalonte koha, aq më shumë pamundësohej ikja nga Brajkoviqi", tregon ai.

AMANETI I ZEQË BISLIMIT LËNË NEJDOR BRAJKOVIQIT!

Duke parë se ishte egërsuar gjendja gjatë luftës së vitit 1999, Zeqë Bislimi i kishte thënë Nejdor Brajkoviqit se e kishte vetëm një dëshirë, që ia linte amanet atij: Nëse vritej, të mos ia lenin trupin mbi dhe, por ta varrosnin! Nejdor Brajkoviqi nuk i kishte kthyer përgjigje, e kjo nënkuptonte se ekzistonte plani për vrasjen e Zeqës, të cilin nuk do ta varrosnin, por trupin do ia gjuanin në ndonjë përroskë. Ai e kishte vështirë të shpëtonte pa e vrarë...

As sot nuk beson si ka arritur të ikte nga Serbia në Kosovë...

Rasti i Zeqë Bislimit, nga komuna e Ferizajt, pas 11 vjet burg shtëpiak dhe shërbim te Nejdor Brajkoviqi, në Serbi, le për të dyshuar se kishte mundësi që në Serbi të mbaheshin pengje shqiptarët për punë krahui, gjë që nuk përjashtohet mundësia që edhe lufta

e vitit 1999 kishte mundësi të ketë prodhuar situatë të ngjashme.

Zeqa ka dyshime se kjo gjë mund të ketë ndodhur, sepse Serbia di të bëjë gjëra të tilla!

Zeqë Bislimi jeton nën dyshime të bazuara se serbët dinë të tjetërsojnë dokumente dhe forma juridike edhe ndaj të zhdukurve, ashtu sikur ndaj banesës së uzurpuar të nënës së tij...

SI ARRITI TË ARRATISEJ ZEQË BISLIMI NGA SERBIA PA ASNJË DOKUMENT IDENTITETI?

Duke treguar pjesën e historikut të tij që ka të bëjë me ikjen nga Serbia, Zeqë Bislimi përshkuan ikjen dhe thotë:

"Disa ditë dola në krye të arës, e që kishte pamjen kah rruga ku i shihja disa kamionë me tabela "Proba". Mendoja me vete se çka mund të kishin ata kamionë me ato tabela...

E kisha lëshuar mjekrën dhe e kisha në kokë një shajkajkë (kapelë serbe). Nuk dallohesha me asgjë se isha shqiptar, pos atyre që më njihnin në rrethin e Brajkoviqit.

I shihja kamionët se ktheheshin në drejtim të Kosovës. Dola në rrugë dhe mendoja të flisja shqip a serbisht. Prej së largu më dukeshin se ishin shqiptarë, por nuk isha i sigurt.

E zbulova gjuhën e tyre duke i pyetur me gjeste mos po shkonin për Kosovë. Ata nuk e dinin se unë isha shqiptar dhe nuk do të besonin edhe po t'u thosha...

Dhe, kur i binda se isha shqiptar, më pyetën se çka bëja unë aty. U tregova se jam qëmoti peng, që 11 vjet.

I luta t'më ndihmonin të ikja me ta. Ata më pyetën prej nga isha dhe kënd e kisha në Kosovë. U tregova çdo gjë...

Më premtuan t'më merrnin herën tjetër dhe më thanë a kisha numër telefoni të ndonjë të afërmi, sepse donin ta vërtetonin se nuk e kisha provokim.

E kisha një numër telefoni të një kushëriri dhe ata me të hyrë në Kosovë e kishin thirr atë numër. E thërrasin Selamiun, në Gjilan. I kishin treguar për mua...

Pastaj, ishin takuar me të në hotelin "Kristal" në Gjilan, ku kishin folur për

mua dhe historinë time...

Pastaj, kishin bërë planin si t'më merrnin e t'më kthenin në Kosovë...

Selamiu u kishte premtuar se do të qëndronte pas meje me çdo gjë që ishte e nevojshme, meqenëse ata, të kamionëve, nuk kishin kërkuar asgjë, pos të siguroheshin se nuk ishte ndonjë provokim.

Një ditë, kur pash se kishin ardhur, u afrova afër tyre, kinse punoja diçka...

Më thanë atë natë të bëhesha gati dhe të dilja në rrugë, pasi do më bënin zgjidhje, sikur kishin premtuar "për rizanë e Zotit".

Takimin e lamë në orën 19.30 në mbrëmje. Nga gëzimi hyra të rruhem dhe të rregullohem pakëz. Në shtëpinë e Brajkoviqit u bënë të dyshimtë pse po e hiqja mjekrën, e që e kisha pasur maskë shumë kohë, për t'i shpëtuar më të keqes...

Ka qenë ditë e shtunë. Nuk e harroj kurrë. Në rimorkion e kamionit kishin vënë një gyp kanalizimi dhe më futën në të. Mbi gyp ngarkuan zall, siç ngarkonin gjithmonë.

Isha tepër i frikësuar dhe stresuar si do e kalonim kufirin. Po u zura, e dija se nuk kisha shpëtim. Do t'më vrisnin qind për qind.

Në fund të fundit, nuk kisha asnjë dokument identiteti se kush isha...

Pas shumë kohë vozitjeje, kamioni qëndroi një kohë në vend. Kishte qenë kufiri, e që nuk e dija unë, sepse isha në errësirë, në gypin e kanalizimit dhe nga jashtë nuk dëgjohej zë.

Kur u nis kamioni, eci nja disa minuta e u ndal. Tek atëherë e dëgjova një zë, që më tha se ishim në Kosovë. Nuk mund të besoja dhe më dukej se isha në ëndërr...

Më nxorën nga zalli dhe më morën në kabinë. Kur dola nga gypi, isha tërësisht i djersitur, sepse ajri veç kishte filluar t'më mungonte.

Pas pak thirri në telefon Selamiu dhe ata i treguan se tashmë ishin në Kosovë...

Tha se do vinte t'më merrte, por ata i thanë se ashtu, sikur më kishin marrë në Serbi, do më sillnin në Ferizaj.

Në orën një pas mesnate arritëm në Ferizaj, ku na priste Selamiu. Kishte bërë darkë në shtëpi, por askush nuk mund të hanim nga lodhja e madhe..."

S. Krivaça

Si harroi rugovasi ku e ka shtëpinë?

Ishte një shteg shëtitjeje ku dilnim për ecje. Dola të ecja atë mbrëmje vere dhe fqinji im kthehej për në shtëpi. Ai kishte bërë peshë trupore dhe dilte ta hiqte atë.

"Ik mik!", më bërtet mua dhe sa mundet qet hapin.

"Prit, komshi, çka ka ndodhur, tregomë ta di!"

"Pak më larg, në shteg, është një ari. Është ndalur në rrugë dhe nuk po e lëshon rrugën".

"Ari?"

"Po, është një ari, sapo e pash. Isha kah shkoj drejt e në të! Falë Zotit e pash se për pak do të më shqyente!"

"Ndal, bre komshi, a u nis ai këndeje kah ne, apo mbeti aty në vend?"

"Jo, aty e lash, por falë Zotit nuk më pa edhe ja mbatha".

Ishte mbushur frymë, mezi fliste.

"Komshi, asgjë nuk po lëvizë, ndoshta është ngjitur kodrës, është futur në mal", i them unë.

"Po thua, a?", më tha.

"Eja ngadalë, shkojmë e shohim, nuk jemi larg shtëpive, e po na ndoqi nuk

do na zë, sepse futemi në shtëpitë tona".

"A ke diçka me vete?", më pyeti.

"Jo komshi, nuk jemi më në luftë me mbajt armë me vete", i them unë.

NGA FRIKA CUNGU I DUKEJ ARI!

Ecim tutje dhe posa pamë objektin që, vërtet, i ngjante ariut të shtrirë në rrugë, ndaluam të shikonim se a do lëvizte a jo. Pritëm e pritëm, por ai nuk lëvizi.

"O komshi, ky nuk po lëviz. Ka mundësi që dikush ka lënë diçka dhe ka shkuar. Komshi, e di ti punën e rugovasis?", i them unë.

"Jo", më thotë ai.

"Eh, dëgjoje pra: Një rugovas shkon në Katund të Ri për të marrë një thes grurë dhe kthehet për në Rugovë. I lodhur nga pesha në shpinë e lëshon thesin në tokë.

E, posa pushon pak e zë gjumi. Kur zgjohet e sheh thesin, por nuk dinte në cilin drejtim po shkonte, andej

apo këndeje. Nuk i binte në mend kah duhej të shkonte.

Dhe, teksa mendohej, aty pari kaloi një plak dhe pasi përshëndeten i thotë plakut:

"Çka po pret, a e ndezim nga një duhan?"

Rugovasis i vjen inati t'i tregojë plakut se e ka harruar rrugën, por i thotë:

"E kam këtë thes, por më lodhi pak.

Kur u ngrita mu morën mendtë dhe nuk dija kah isha duke shkuar".

Plaku e pyet:

"Çka ke në thes?"

Rugovasi i tregon se ka grurë. Plaku atëherë i thotë:

"Këndeje janë Bjeshkët e Nemuna, se atje nuk ka grurë... Se prej Rugove kurrë askush nuk ka qar grurë në rrafsh".

Kështu, pra, si ai rugovasi, ka mundur dikush ta linte ndonjë thes e na duket si ari, komshi.

Frika e ka bërë të veten, të kanë mbetur pasojat nga gruaja e tash edhe cungat të përngjajnë në arinj të malit!

S.



KOSOVA AIRLINES eurokoha

flyksa.com | eurokoha.eu



0 burrë, ti në ara e unë me shoqe në deti!

Isha duke u dremitur në orët e pasdites, kur dyert e fqinjit kërcitën fort. Mendova se mund të ishin hajnat, të cilët i futen shpesh lagjes sonë. Në shpejtësi dola në tarracë të ballkonit. Ilazi, një kujdestar i mëhalls, që e qon kohën kot, veç ishte fshehur pas mollës në oborr dhe po shikonte se çfarë po ndodhte te fqinji...

Diçka ndodhte te fqinji ynë i urtë. Ai kurrë nuk ka mbytur as mizë e shkelë thënegël. I ngjan tregimit për njeriun më të butë të fshatit, i cili kishte vendosur zile të vogla në fund të pantallonave dhe, kur e kishin pyetur nëse ishte çmendur duke ecur me kambana, kishte thënë se druante se do të shkelte ndonjë thënegël, prandaj duke vendosur sinjale akustike i trembte nga rruga.



Kështu, disi dukej, edhe fqinji ynë, të cilit iu kishte gjuajtur policia në shtëpi. Nuk vonoi shumë dhe tërë mëhalla dolën në rrugë, sikur të kishte rënë tërmeti. Ndonjëri habitej se çka do i ketë ndodhur fqinjit, tek i cili ishin futur policia, e ndonjëri thoshte se vetëm Zoti e di se çka ka bërë fqinji ynë, e tjetri thoshte: "Kurrë mos thuaj se e njeh mjaft as fqinjin me të cilin ke jetuar tërë jetën!"

A DHUNOHET GRUAJA ME 20 VJET MARTESË?!

Nuk vonoi shumë dhe policia dolën nga shtëpia, me fqinjin e prangosur në duar. Gruaja e tij nuk u pa kund... Të nesërmen në portalet elektronike kudo shihej emri i fqinjit tonë. "A... dhunoi gruan. U dërgua në mbajtje të

arrestit".

Dhe, nuk isha vetëm unë që e kisha parë këtë informacion, por ishin edhe shumë të tjerë që e kishin lexuar para meje dhe tek shprehja habinë, fqinjët ishin mbështetur për murin e oborrit tim dhe po e komentnin atë që edhe unë e kisha lexuar.

Dola edhe unë t'u bashkëngjitëm, sepse m'u duk si një lloj proteste paqësore...

"Si jeni fqinjët e mi? A po e mbani murin nga frika se përmbysët, a?". "Po, jemi bërë si Nastradini!", tha njëri. "Ore, lëre ti mahinë, por a e di pse A... e nxorën me pranga në duar nga shtëpia?".

"Jo, akoma nuk kam asnjë lajm. Dhe, në anën tjetër, ku të di unë se çka bëjnë burrat e gratë në shtëpitë e tyre?".

"Eh, more burrë, e kish dhunuar

gruan!”, ma ktheu një tjetër.
 “Si?!”, pyes me habi.
 Ha-ha-ha, qeshen të gjithë.
 “Mos u tallni me njeriun e prangosur!”, u them unë.
 “Jo, ore burrë, nuk është shaka, por e kanë prangosur se e kishte dhunuar gruan”, më thotë i treti.
 “Po, si dhunohet gruaja pas 20 vjet martesë e me tre fëmijë të rritur, bërë burra, o njerëz?! A jeni në vete?!”, u them me nervozizëm.
 “Ashtu doli, he burrë, çka dimë ne!”, u përgjigjën 2-3 vetë njëzëri.

SA JA ARRESTOJNË BURRIN, GRUAJA JA THERR PËR NË DETI!

Dhe, askush prej nesh nuk do të kishim mbetur pa arrest sikur të kishin qenë gratë tona si ajo e fqinjit, që të nesërmen ja shkeli për në deti...
 Ndërkaq, A... nuk e mbajtën më shumë se tri ditë dhe e lëshuan, sepse, me siguri, s’kishte bërë vepër që ta dënonin...
 Pas lirim të tij u takova te muri i oborrit tim me disa fqinj, që ta bënim meshliz nëse duhej të shkonim ta vizitonim fqinjin tonë, që sapo ishte liruar nga burgu.
 E, çka t’i thoshim?
 Por, askush nuk dinte se si të vepronim... Edhe ai do të ngushtohej, me siguri, por edhe ne...
 Dhe, ditën tjetër, tek rrija në rrugë, fqinji im i akuzuar nga gruaja po kthehej nga puna.
 “Përsëendetje komshi!”, i

them unë.
 Ai ma ktheu:
 “Asnjëri prej fqinjëve nuk meritoni t’u kthej përgjigje, por jam ai që kam qenë gjithmonë dhe po u përsëndes përsëri...”.
 Çka dreqin t’i them komshiut?!
 “Ke të drejtë, por, për zotin, disi u ndiem keq të vinim, se i ndodhin njeriut këto gjëra...”, i them unë, si kundërpërgjigje të një arsytimi që nuk kisha qenë ta shihja pas lirim nga burgu.
 “Po të kishe ardhur ti, bile, si fqinji i parë, do isha ndier i lehtësuar. Para së gjithash, do u tregoja historinë e arrestit tim, se tani po ikin njerëzit prej meje...
 Unë nuk jam dhunues, he burrë! Si mund ta dhunojë burri gruan pas njëzet vjetësh martesë?!”.
 “Nuk di komshi, ne nuk e shpikëm këtë gjë, por ajo doli nga shtëpia jote”, ia ktheva.
 “O komshi im, gruaja ime kish pas vendosur me shkua në det me shoqe të veta! Më tha një javë para se të shkonte, por unë nuk e lejova...
 I thash se do të shkonim bashkë, e ajo nuk pranoi të shkonte me mua.
 Dhe, kur unë e kundërshtova, ajo ma punoi shpikjen dhe shteti, jo që i besonte, por duhej ta kryente kinse procesin e arrestit.
 Kështu ka ndodhur dhe ajo e bëri të veten, duke shkuar atje me shoqërinë e vet, e unë duke mbetur në burg!”
 “Uh, komshi im, bre, po keq ta paska punuar!”, i thash me keqardhje.

S. M.



Ronela Hajati: Pse njerëzit mendojnë vetëm keq për mua?!

Ditë më parë, Ronela Hajati ka qenë në një festival në Spanjë, ku, si duket, është pritur shumë mirë nga publiku.
 Ajo solli në skenë një version të ri të këngës “Sekret”, teksa u shfaq e veshur me një set ngjyrë blu dhe portokalli.
 Teksa ka publikuar një video nga performanca e saj në Madrid, Ronela ka sjellë në vëmendje kritikën që mori gjatë “Eurovisionit”...
 Ajo thotë se askush nuk u mor me veshjen e saj dhe nuk nxori justifikime për të gjetur diçka keq, siç jemi të prirë të bëjmë.
 “Në fakt, nuk u mor njeri as si isha veshur, as nuk shpiken 100 justifikime për të gjetur, patjetër, diçka keq...
 Në fakt, në Spanjë, si dhe kudo tjetër në Evropë, çdo përfaqësues i shtetit, pavarësisht çdo lloj rezultati, kanë pasur suportin pozitiv të medieve gjithmonë!
 E, versioni i ri i këngës “Sekret” i bëri edhe njëherë njerëzit të këndojnë shqip!”, thotë ajo.

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Në kontaktoni në Info@remos-restaurants.de



[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

Modele: Violeta Arbëri

BOOM

*Cilët janë
konsumuesit
e gjërave
të këqija
në estradë?*

*Kush
po e vjedhë
Agnesa
Vuthajn?*

Violeta Arbëri
po sjell linjën
e parfumeve
"Violet Parfums"

Violeta Arbëri sjell linjën e parfumeve “Violet Parfums”

Violeta Arbëri është zonjë e rrallë, nga ato femra që secilin hap e hedh me kujdes, logjikë dhe bindshëm. E suksesshme në jetën profesionale dhe atë private, Violeta Arbëri është modeli i gruas, e cila ka arritur ta balancojë në mënyrën më të mirë rolin e të qenit grua e përkushtuar në zhvillimin personal dhe atë të punës.



E bukura që e shohim në rrjete sociale, duke shëtitur sa në një eveniment gjigant e sa në një tjetër, shoqëruar nga i shoqi Jimmy, por edhe njerëz me influencë në jetën publike, pikë të fortë e ka edhe stilin.

E angazhuar në biznes, modë, menaxhim dhe veprimtari të ngjashme me to, Violeta arrin t'i japë ngjyrat më të bukura jetës, copëza të së cilës shpesh plasohen në faqen e saj me shumë ndjekës në “Instagram”.

Bisedat me Violeta Arbërin, zakonisht, vërtiten rreth punës, biznesit, por edhe familjes, që njëkohësisht është dobësia e saj më e madhe.

Është bashkëshorte dhe nënë e dedikuar e dy djemve tashmë të rritur. E, të bërit nënë në moshë të re, ia ka mundësuar Violetës të duket si shoqe e djemve të saj. Pejanja, e martuar në Mitrovicë, jeton prej vitesh sa në Zvicër e sa në Prishtinë. Jeton në luks, por modestia e saj është luksi më i madh që e vërejnë njerëzit.

Ndonëse është grua e suksesshme dhe e pashme, Violeta Arbëri njihet për modesti, sinqeritet e lojalitet.

Kur është pyetur se a e jeton ëndrrën, ajo është përgjigjur: “Fal punës së pandalshme, vizionit të qartë se çka dëshirojmë në jetë dhe fatit që na ka përcjellë në jetë, jetojmë ëndrrën tonë sipas mënyrës sonë”.

VIOLETA - GRUA ME IDENTITET

Përtej të qenit yll Instagrami, Violeta është një menaxhere e



shkëlqyer e biznesit familjar, merret me patundshmëri dhe ka një rrjet të gjerë shoqëror, me të cilët kalon kohë cilësore.

Së fundi, ka ndërmarrë një bashkëpunim me Ajkune Ahmetin dhe bëhet fjalë për një qendër ekskluzive bukurie në Cyrih, konkretisht në qendër të Orlikont.

“Kam hyrë në bashkëpunim me Ajkunën, pasi e karakterizon profesionalizimi dhe përkushtimi në ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe profesionale për gruan”, thotë ajo. Se Violeta vishet bukur, dihet. Kombinimet e saj janë shik dhe inspirojnë mijëra femra që e ndjekin në “Instagram”.

Thotë se stilit të të jetuarit dhe të të veshurit i kushton një pjesë të mirë të kohës së saj, ndërkohë që nuk preferon të flasë për gjërat e shtrenjta në gardërobën e saj.

Violeta Arbëri, në shtator lanson markën e parfumit të saj “Violet Parfums”, që vjen në tri linja: “Violet Venum”, “Violet Dark Fantasy” dhe “Violet Secret”.

Pra, suksese!

N. Neziri



Cilët janë konsumuesit e gjërave të këqija në estradë?

Jemi dëshmitarë të shumë ngjarjeve të hidhura që po ndodhin kohëve të fundit se a konsumohet masovisht droga, alkooli, a ka dhunë, kriminalitet e prostitucion në estradë...

SHOTA BARALIU:

- Të them të drejtën, besoj se ekzistojnë të gjitha nga pak në botën e artit, në përgjithësi. Dhe, këtë e them me plot kuptimin e fjalës, duke marrë parasysh se kam parë edhe me sytë e mi kolege e kolegë, të cilëve u është dukur vetja shumë të famshëm, apo ku ta di unë dhe janë futur në rrugët e gabuara, ku dhe shëretet nuk mungojnë.



STRESI:

- Thjesht, është një realitet që duhet të përballemi ditë për ditë në jetën sociale. Ka shumë këngëtarë që përdorin lëndë narkotike. Kam parë me sy shumë sosh dhe më vjen keq për to. Gjithashtu, ka shumë raste që ato shesin trupin e tyre për famë ose, më saktë, të arrijnë deri në tregun shqipëtar. Kjo është e keqja e këtij realiteti, sepse ka shumë viktima që i shtyn kurioziteti të harrojnë realitetin e vërtetë.

GJYSTE VULAJ:

- Skena shqiptare, shyqyr, është larg nga këto të këqija, por ka një numër të vogël që mund t'i numërojmë në gishta të dorës, të cilët konsumojnë drogë, por deri më tani nuk kanë kaluar dozat e përdorimit, jemi fukarenj për ta ekzagjeruar.

E, sa i përket alkoolit, e konsumon pothuajse çdo njeri i rritur (pak a shumë) dhe të paktë janë ata që s'dinë të kontrollohen.

Prostitucion në muzikën shqiptare mendoj se nuk ka. Mendoj dhe shpresoj falë mentalitetit tonë dhe rrethanave ku jetojmë, se edhe shumë breza të tjerë do ecin në rrugë të sigurt.

Populli shqiptar nuk është edhe aq i ngarkuar apo i mbytur me punë, sa të mos kenë kohë t'i edukojnë fëmijët e tyre...



GOLD AG:

- Për fat të keq, ka dukuri të tilla në botën e muzikës mbarëshqiptare. Sa u përket lëndëve narkotike, ka raste të shumta, por shpresoj se një ditë të pendohen për atë që bëjnë, sepse më mirë vonë se kurrë.

E, sa u përket rasteve të këngëtarëve që arrijnë majën e suksesit pa talent, por në mënyra të tjera, ata janë të përkohshëm dhe nuk do përmenden gjatë.

D. H.

Kush po e vjedhë Agnesa Vuthajn?



Agnesa, e njohur për linjat trupore, bukurinë e saj dhe stilin modern, mund të konsiderohet si një femër e cila shkon gjithherë duke u rinuar. E, përkrahë modelizmit është e fokusuar edhe te biznesi i saj i modës, ku po shënon sukses të madh. Por, ish-“Miss Kosova”, Agnesa Vuthaj, ka rënë pre e një grabitjeje. Ajo e ka denoncuar ngjarjen në Policinë e Kosovës, ku ka deklaruar se në shtëpinë e saj në Çagllavicë kanë hyrë disa grabitës. Bukuroshes i kanë vjedhur një shumë të konsiderueshme parash dhe stoli të çmuara ari. Ndërkohë, nga vetë Agnesa nuk ka pasur asnjë reagim publik. Shtrohet pyetja: Kush po e vjedhë ish-“Miss Kosovën”?

OFERTA E KORRIKUT

20%
ZBRITJE

Vlen të Premtën dhe të Shtunën

30%
ZBRITJE

Vlen nga e Diela deri të Enjtën

Mëngjesi | SPA | Fitness



★★★★★
BREZOVICA
HOTEL & SPA

Një jetë me këngë të suksesshme

Xhavit Sadiku, emër shumë i adhuruar dhe i njohur i muzikës popullore, para pak ditësh ka lansuar albumin më të ri me 15 këngë, të titulluar "O ju shokë".

Ky album është shkas i bisedës me këngëtarin e mirënjohur Xhavit Sadikun, që cilësohet këngëtar i me zërin më të mirë në melosin shqiptar.

Xhavit Sadiku është qe një jetë të tërë artist i skenës së muzikës popullore shqipe, që dallon nga të gjithë këngëtarët, për faktin se nuk këndon për komercialitet, por për shije muzikore.

Një jetë të tërë këndon bukur dhe ëmbël. I pranishëm në skenë dhe ekrane televizive, e dasma e ahengje, prioritet shpirtëror e ka këngën e pastër popullore shqipe.

Megjithatë, këngëtar i thotë se sot pothuajse është e pamundur të shmangesh nga muzika tallave, që është modë e kohës! Xhavit Sadiku është ngritur si këngëtar hap pas hapi dhe nuk bën pjesë në grupin e këngëtarëve që shpejt ngrihen e shpejt bien pa lënë gjurmë në skenë.

Edhe pse nuk është përkushtuar në këndim tjetër pos në stilin popullor, Xhavit Sadiku e di se sot është vështirë të mbijetohet skena pa e përzier këngën me tallave...

MBURRET QË I TAKON KOHËS SË KËNGËTARËVE TË MËDHENJ

Dhe, duke folur për opusin e vet krijues, mburret që i takon kohës së këngëtarëve të mëdhenj.

E, duke treguar detaje të historikut të vet si këngëtar, ai thotë:



"E kam filluar karrierën muzikore në vitin 1974. E kam nisur rrugën e këngës me Demir Krasniqin, që e kam nder dhe kënaqësi, sepse të këndoje me Demirin kishte njeri më shumë besim në vete. Kam qenë anëtar i Shoqërisë Kulturore-Artistike "Ramiz Sadiku", shoqëri studentore, rreth së cilës silllej një brez i tërë këngëtarësh me ambicie të mëdha këndimi.

Ata që ishin pjesë e kësaj shoqërie, synonin të linin gjurmë edhe në vlera kombëtare përmes këngës...

Nga vitin 1978 kalova në SHKA "Bajram Curri", ku kam qëndruar deri në vitin 1982", thotë ai.

KËNGËTAR BESNIK NDAJ ORIGJINALITETIT TË KËNGËS POPULLORE SHQIPE

E, duke folur rreth organizimit të këndimit në Kosovë, Xhavit Sadiku flet për aspekte të shumta të këndimit origjinal dhe tjetërsimin e muzikës popullore shqipe.

"Kanë mbetur "Kastriotët" e Ferizajt ata që e kanë ruajtur muzikën shqipe.

Në Gjakovë është grupi i Xenit dhe i Edi Furrës.

Në Pejë është Ramadan Krasniqi-Dani, të

cilin e konsideroj si një ndër këngëtarët më të mëdhenj.

Gjithashtu, mendoj se Sinan Vllasaliu dhe Afrim Muçiçi janë këngëtarët që e kanë ruajtur muzikën shqipe në masë origjinale. Po ashtu, edhe Selvete Tërstena, Nazife Bunjaku, Shkurte Fejza dhe Remzie Osmani këndojnë në këtë frymë.

Të tjerët, me pak përjashtime, 90 për qind kanë kaluar në tallave...

Sidoqoftë, ata që kanë personalitet nuk e ndërrojnë vetveten e as zhanrin.

Tash ka këngëtarë që vijnë shpejt në skenë, duke bërë emër, por edhe shkojnë shpejt!", thotë Xhavit Sadiku.

PSE PO DËGJOHET SHUMË KËNGA TALLAVE?

Kur jemi te kritika, Xhavit Sadiku nuk do të flasë me emra për devijime muzikore, që e kanë kapluar muzikën popullore shqipe në gjithë hapësirën shqiptare.

"Krijimtaria jonë popullore jep shumë mundësi të ruajtjes së muzikës popullore. Kemi shumë këngë e legjenda, shumë potenciale dhe burime që të bëjmë muzikë të mirë.

E, masa e njerëzve që më dëgjojnë mua më kanë thënë të mos ndryshoj asgjë... Të njëjtën bindje e kam edhe unë gjithmonë. I takoj rangut të këngëtarëve që

e duan muzikën popullore dhe e çmoj shumë Ismet Pejën.

Kam pasur fat ta kem Zekeria Çerkaxhiun udhëheqës artistik, i SHKA-së "Hajdar Dushi", i cili, pasi erdhi në Prishtinë, më dha një orientim të shëndoshë muzikor dhe i jam mirënjohës për këtë gjë, sepse kam mësuar shumë prej tij.

Andaj, me Zekerian në SHKA "Bajram Curri" kemi arritur shumë.

Në vitin 1981-1982 u bën disa ndryshime në atë shoqëri dhe tek pas atyre ndryshimeve vendosëm ta formonim grupin e pavarur "Xhevahirët", meqë na u imponua situata", tha Xhavit Sadiku.

Sofie Thaçi, redaktore në RTK, e pagëzoi grupin tonë me emrin "Xhevahirët".

"Kur shkua në RTK të xhirojmë një këngë, Sofia tha: Si do të prezantoheni? Dhe, meqë ishim të rinj dhe dukeshim bukur, të pashëm, morëm prej saj epitetin - xhevahirë. Dhe, nga ajo kohë njihemi me këtë emër.

Kemi qenë pesë anëtarë nga ajo strukturë, e tani jemi tre aktivë, si dhe dy të tjerë që na ndihmojnë gjatë punës.

Klarinetisti ynë, Remzi Mehmeti, ka vdekur dhe nuk është në mesin tonë.

Deri në vitin 1990 më shumë kemi qenë si grup në koncerte, dasma, incizime televizive etj.

Pas viteve 90 muzika na u bë profesion, sepse e shfrytëzuam për të mbijetuar, sikur e tërë estrada jonë.

MALTRETIMET E GRUPIT "XHEVAHIRËT"


Grupi i njohur "Xhevahirët" ka bërë muzikë për të mbijetuar, duke kënduar në dasma e në restorante.

Peripecitë që ka përjetuar Xhavit Sadiku, i shoqëruar nga instrumentisti Fatmir Thaçi, tregojnë një pjesë të atyre ngjarjeve:

"Kemi kënduar shumëkund nëpër Kosovë. Gjatë atyre viteve, e që janë një dekadë, kemi pasur disa raste të pazakonta...

Duke shkuar në Shtime, gjatë viteve 90, policia në Lipjan, pasi na nxori nga vetura, na detyruan të qëndrojmë në stacionin policor të shtrirë mbi borë.

Sipas tyre, arsyeja ishte pse këndonim



këngë patriotike.

Rasti tjetër ishte në Graçanicë. Teksa ktheheshim nga Gjilani, një polic serb hipi në veturën tonë dhe na urdhëroi të ndryshojmë drejtimin - të kthehemi për në Kishnicë. Me këtë rast ndodhi edhe një gjë e pazakontë: Ishte ora 4 e mëngjesit. Para veturës sonë doli një lepur në rrugë. Polici e urdhëroi shoferin tonë, Nazmi Kllokoqin, klarinetist, ta ndiqte lepurin me veturë nëpër ara, kurse ai me automatik shkrepse plumba drejt tij...

Kemi kënduar edhe në Tetovë, Gostivar, Preshevë, Bujanoc, si dhe në Zvicër deri më 1999. Dhe, tërë kjo etapë mund të cilësohet si kohë mbijetese nga kënga", tha Xhavit Sadiku.

KRIJIMTARIA E GRUPIT "XHEVAHIRËT"

"Xhevahirët" kanë muzikë të pasur, e cila dëgjohet shumë dhe me ëndje.

"Albumi ynë i parë ka qenë "Lulëzoi fusha lulëzoi mali". Pastaj, vijnë albumet tjerë me radhë...

I kemi 12 albume me këngë të përpunuara. Ne i këndojmë edhe këngët e "Hajdar Dushit" dhe kemi lëvdata nga njerëzit që na dëgjojnë.

Unë nuk e këndoja atë që nuk mund ta këndoje. Zakonisht, heq dorë nga ato këngë që nuk më shkon këndimi.

Nuk ka këngë që e kam kënduar nëse nuk e kam kënduar si duhet. Këngët e mia, kur i këndo, më ringjallin, më japin kurajë, si kënga "Jalla u shembsh moj kalaja e Durrësit". E, kjo është një nga këngët që më fle në shpirt.

Gjithashtu, i veçoj dy këngë të karakterit patriotik:

"Këngë për Adem Jasharin" dhe "Këngë për Jusuf Gërvallën".

JETA PRIVATE E XHAVIT SADIKUT

"Jam nga fshati Leshtar, komuna e Kamenicës. Shkollën fillore e kam mbaruar në fshat. Më kanë kritikuar pse nuk kthehem në fshat dhe pse kurrë nuk kam bërë propagandë se jam i atij fshati. Megjithatë, mburrem që jam nga fshati Leshtar. I takoj gjeneratës së vitit 1958. Jam inxhinier dhe punoj në KOST (Operatori i Pavarur i Sistemit Energjetik të Kosovës). I kam katër fëmijë: tre djem e një vajzë. Nga aspekti muzikor nuk janë të interesuar t'më trashëgojnë, megjithëse Bashkimi më ndihmon në studio dhe aktualisht është në studime për master dhe punon në komunë", tha Xhavit Sadiku.

ÇKA PRESIM NË TË ARDHMEN NGA "XHEVAHIRËT"?

Xhavit Sadiku sugjeron se muzika në Kosovë të kalojë në binarë normal dhe më shumë të komponohet mbi motivet e pasura që posedon muzika shqipe, prej nga mund të bëhen edhe këngë të mira. Ai thotë se duhet hequr nga trendi muzikën që po na e shkatërron kulturën e pasur muzikore dhe të traditës.

Instrumentisti, Fatmir Thaçi, thotë se Xhavit Sadiku është 50 për qind i grupit. Thjesht, thotë ai, nuk do bëhej asgjë në këtë grup pa të...

Sidoqoftë, orientimi i "Xhevahirëve" është të mos dalin nga kauza e tyre, por të këndojnë vetëm shqip, ashtu si deri më tani...

Safet Krivaça

Si e takova simpatinë time pas 35 vjetësh?

U takuam në plazh pas 35 vjetësh. Ajo më thoshte të protestoja pse isha rritur e bërë burrë. Dhe, në fund, u bindëm se kishim jetuar për atë ditë 35 vjet!



Një zonjë e rëndë, shtathedhur, po qëndronte në zallin e Plazhit të Madh të Ulqinit me një libër në dorë. Më dukej se ishte më e preokupuar me fëmijët që laheshin në det sesa me librin që e mbante në dorë. Unë isha shtrirë në drejtim të ujit të detit dhe vështroja një pulëbardhë, e cila afrohej deri afër meje në kërkim të ushqimit.

Dhe, mu kujtua në çast një ndodhi e para sa e sa vjetëve, kur isha në vitin e parë të shkollës së mesme...

Aso kohe pata botuar vjershën e parë me titull "Miku i zogjve". E, si një djalë që nuk e kisha ndërruar kurrë frizurën, jetoja me krenarinë për vjershën e botuar.

Aso kohe nënës sime i kishte thënë një e njohur e jona se më donte. E, nëna ime vetëm i kishte buzëqeshur dhe nuk i kishte thënë dot gjë. Dhe, kur arrita në shtëpi, nëna më tha se filania... i kishte thënë se më donte mua...

"A ke pasur ti guxim t'i thuash babait se e do?", i thash nënës.

"Jo, s'kam pasur!", ma ktheu ajo.

"Eh, e sheh ti, ajo ka guxim dhe të paska

thënë se më do mua!", ia ktheva unë. Dhe, e di se me kaq u përmbyllë ai kapitull i asaj kohe...

AJO ME SY SI TË GJARPRIT...

Në Ferizaj, në atë kohë, kishte shumë poetë, madje ekzistonte edhe grupi letrar "Jeronim de Rada", në të cilin edhe tuboheshim ne, të interesuarit. Aty ndodhej edhe ajo, e cila i kishte thënë nënës sime se më donte mua... Andaj edhe më kishte kapluar vala e syrit të saj, mua, djaloshin që zgjohe-sha me frizurën që ma krijonte natën jastëku ku flija.

Dhe, në gjithë atë përpëlitje mendimesh, mu kujtua tash mu ajo, të cilën ma pat "grabitur" profesori nga Ulqini.

Ajo, aso kohe, mbaj mend, kishte sy si të gjarpërit... E, mu ata sy më bëhej se i shihja edhe tash, teksa rrezitesha në plazh...

E, kur pa se unë veç isha tretur në mendime, mu afrua edhe më afër dhe më tha:

"Hyj nën ombrellë se të djegë dielli!"

"Mirë e ke, sepse kur ndizem nuk më

fikë as deti!", ia ktheva.

"Dukesh i dëshpëruar?!", vazhdoi tutje.

"Jo, as i lumtur e as i dëshpëruar! E, mesi qenka më i vështiri", ia ktheva.

KUSH DO FLISTE ME NJË BUDALLA SI UNË?!

Në moment ra heshtja. Ajo uli kokën dhe më la përshtypjen se me kaq përfundoi edhe ky "teatër". Dhe, në çast mendova se kishte të drejtë...

Sepse, kush do të fliste me një budalla si unë, i cili në vend të fjalëve të bukura shprehte dëshpërimin pse ishte rritur...

E ajo, sygjarpërushja, u afrua shumë pranë meje dhe më tha:

"Ti ende i paske sytë e njëjtë!"

"E, ku m'i njeh ti sytë mua?!", ia ktheva me habi.

"T'i njoh, sepse unë jam ajo... ajo që më pat "rrëmbyer" profa i Ulqinit...", më tha me një buzëqeshje të lehtë.

"Ti... ajo?! Ti?!", belbëzova në vete.

"Po-po, vetë unë! Dhe, 35 vjet e kam pritur këtë ditë, këtë takim...", më tha, duke ma shtrënguar dorën fort.

S. M.

HELPER
GENEVE



www.helperwatches.com

 /helper_lifestyle



Si jetohet sot në Janjevë?

Janjeva, as fshat e as qytet, ka traditë të pasur ndërkulturore dhe paraqet një mjedis të begatë vlerash arkitektonike të stilit dalmatin. Kisha katolike dhe xhamia e re nuk pengojnë njëra-tjetrën, ani pse funksionojnë në afërsi të dukshme. Oborri i xhamisë është pajisur me pak lojëra të fëmijëve, ku lozin fëmijë shqiptarë dhe kroatë.

Të dielën e ngrohtë të 3 korrikut, Janjeva mbizotërohej nga banorët me mbushjen e rrugicave të gurta të stilit të Zarës së vjetër. Qendra e qytezës, e që tani është pushtuar nga xhamia e re, është bërë një atraksion edhe për fëmijët e komuniteteve shqiptarë e kroatë, që lozin së bashku në lojërat e parkut të xhamisë, që i ka siguruar xhamia për banorët e rinj të qytezës. Janjeva është ndër vendbanimet e rralla që nuk është as fshat e as qytet. Qyteza që prodhonte suxhukun më të mirë, e që mbahej mend, ishte e pazez-istueshme për shumë ish-funksionarë politikë të ish-Jugosllavisë. Stane Dollanci dhe një numër sish, që vinin nga ish-federata dhe shërbimet e punëve të brendshme të ish-Jugosllavisë, ditët e vikendit i kalonin me suxhukun e Janjevës, që e prodhonin me recetë speciale kroatët e pasur, e që ishin bërë milionerë falë marrjes edhe me bizhuteri, e që furnizonin tregun e mbarë Ballkanit.

KROATËT E JANJEVËS A KANË LIDHJE ME DALMACINË ILIRE?

Tregu i kroatëve të Janjevës, që kishin lidhje gjenetike me Dalmacinë ilire të bregdetit, kishte hapur rrugën tregtare nëpër Bjeshkët e Nemuna të Rugovës për të shkuar në Dalmacinë e sotme.

Baza e tregtarëve të zanateve të bukurisë ishte Raguza (Dubrovniku) e lashtë dhe Zara e Relës, pa lënë anash as trevën autentike vendore të At Shtjefën Gjeçovit të Janjevës.

Shtëpia e tij është shndërruar në muze monumental dhe ka marrë mbrojtjen institucionale në mesin e shtëpive të boshatisura të kroatëve që braktisën Janjevën masovikisht nga viti 1990-1992.

Dy vitet e ikjes së kroatëve ishin vitet e lotëve edhe për shqiptarët që kishin krijuar treg të konsoliduar, duke ndi-

hmuar njëri-tjetrin sa për punë aq edhe për sigurinë e tyre, deri në ditën kur i pari i çetnikëve, Vojislav Shesheli, gjatë një vizite në Janjevë, ua tregoi kroatëve thikën e përgjakur të Vukovarit, duke i kërcënuar se edhe kroatët e Janjevës i pret thika në një të ardhme të afërt.

Dhe, pak ditë pas asaj deklarate, të thikës së përgjakur të Sheshelit, kroatët e Janjevës filluan të shpërngulen masovikisht për në Kroaci.

Janjeva, për të cilën mund të shkruhen libra, është një qytezë e rrallë multietnike dhe ndërkonfesionale, në të cilën jetojnë edhe rreth 50 familje turke, që mbajnë këtë regjistrim edhe zyrtarisht, duke u njohur si pakicë turke në Janjevë. Janë edhe dhjetëra familje rome e ashkalinj. Por, në të pjesa dërmuese janë shqiptarë, të ardhur nga fshatrat rreth Janjevës, si nga Hanroci, Vogoçinca, Brusa etj., por ka edhe banorë kroatë që nuk e kanë lëshuar qytezën.

Ç'THONË BANORËT E JANJEVËS?

Ramadani, teksa shkonte në xhami për të falur drekën, thotë për revistën tonë se aktualisht në Janjevë jetojnë rreth 250 kroatë.

“Unë jetoj këtu që 50 vjet. Situata është e mirë, ka siguri ndërmjet banorëve që jetojnë këtu, por ka edhe skamje shumë. Kam punuar në fabrikën e këtushme “Metallac”, por tani më thonë se stazhi im i punës është i mangët për ta pasur një pension të plotë pune.

Pas shpërnguljes së kroatëve në vitet 1990-1992, Janjeva u ripopullua me shqiptarë nga fshatrat përreth, si nga Bukovica, Hanroci, Vogočinca, Brusa. Por, Janjeva nuk e mori kurrë më primatin e qytezës së njohur, e që lidhte shumë tregje atraktive ballkanike. I shihni edhe vetë si kanë mbetur qindra shtëpi të boshatisura, oborret e të cilave janë mbushur me therra e barishte?!”.

Ramadani, e që i takon komunitetit turk në Janjevë, nuk lë pa kritikuar qasjen e shtetit të pasluftës në Janjevë, që ka për komunë Lipjanin, duke mos e evituar skamjen dhe mosinvestimin e nevojshëm në infrastrukturë.

SI U SHPËRNGULËN KROATËT E JANJEVËS?

Lufta në Kroaci nisi më 1991, kur forcat serbe me teknologji ushtarake të ish-Jugosllavisë sulmuan Kroacinë, duke tentuar të copëtonin atë gjeografikisht. Kulmi i luftës atje kishte arritur në vitin 1992, kur kroatët me Gardën e vet ushtarake arritën sukseset e para të fitoreve dhe pikërisht në këtë mllaf, i pari i çetnikëve serb, Vojislav Shesheli, kishte ardhur në Janjevë t’ua tregonte thikën me gjak kroatëve. I shoqëruar nga serbët vendorë të fshatrave të Lipjanit, ai i kërcënoi kroatët: “Së shpejti do të jemi këtu për t’ua prerë kokat kroatëve të Janjevës!”. Dhe, pas pak ditësh nisi shpërngulja e kroatëve...

Shpërngulja e kroatëve prej Janjevës zgjati dy vjet. Andaj, gjatë viteve 1990-1992 nga Janjeva ikën për në Kroaci rreth 95 për qind e kroatëve që jetonin në këtë vendbanim. Mbetën vetëm disa familje kroate që kishin lidhje familjare me serbët, e për të cilët nuk parashihej të kishte rrezik nga shteti serb. Skenat që u krijuan në Janjevë ishin akte që vinin nga kreu i Armatës së ish-Jugosllavisë.

Më 6 shkurt 1990, në Janjevë, ndodhi diçka që pak besohej se mund të ndodhte: një oficer serb, që kishte pirë në një kafene të Janjevës, i armatosur me automatik, në rrugicat e qytezës i kishte maltretuar qytetarët dhe në këtë krim kishte plagosur



rëndë dy shqiptarë me të njëjtin emër. Dy Abedina u bënë viktime nga pushka e tij. Ai ishte Tomisllav Isakoviqi, i cili pasi ishte dehur kishte dalë në rrugë dhe kishte shkrepur plumba në kishën katolike e, pastaj, kishte shkrepur plumba edhe në kalimtarët.

Ai e kishte sulmuar Jakup Konxhelin, duke shtënë për ta vrarë. Ai kishte shtënë edhe në kalimtarin Abedin Ymeri. Ai u gjend i shtrirë në tokë nga plumbat e automatikut. E kishin qëlluar plumbat në këmbë.

SHTËPIA E SHTJEFËN GJEÇOVIT

Pak më larg kishës katolike të Janjevës gjendet shtëpia e at Shtjefën Gjeçovit, i lindur në vitin 1873, në Janjevë. Aktualisht

i është rinovuar shtëpia dhe është përshtatur për qëllime vizitorësh. Shkrimtar, etnolog e arkeolog, afirmator i vlerave etnokulturore të traditës shqiptare, ai përgatiti veprën madhore “Kanuni i Lekë Dukagjinit” për botim. Disa fragmente të kësaj vepre u botuan në revistën “Hylli i Dritës”, libër i cili i kompletua e u botua në vitin 1933, në përkujdesjen e Gjergj Fishtës.

At Shtjefën Gjeçovi u vra më 14 tetor 1929, në një pritë të shtetit serb, si kundërpërgjigje e veprimtarisë së Shtjefën Gjeçovit

në sferën e punës së mësimdhënësit dhe shkrimeve patriotike kundër Serbisë.

SI FRYMON JANJEVA SOT?

Kudo rrugëve njeriu has në fëmijë skamnorë, njerëz të papunë, bujq që mundohen rrugicave të Janjevës t’i shesin prodhimet e veta, apo edhe në ata pak kroatë që shesin gjësende bizhuteri, të prodhuara vetë e që kanë traditë në këtë lloj zanati.

Në kafene hasësh në njerëz që rrinë një kohë të gjatë në to, me nga një pije a makiato para vetes dhe e kalojnë kohën, duke mos pasur ku të punojnë...

S. K.



Therrat e Gadimes janë më të mira se lulet e Gjermanisë!

Zbrita nga treni dhe eca një orë e gjysmë deri në shtëpi. Doja të ngihesha frymë të vendlindjes, sepse më kishte munguar ajri sa e sa vjet. Më kishin munguar edhe bari, edhe malet, edhe kodrat...

Te "Bregu i mullirit" ngrita kokën ta gjeja odën e babait, me krenarinë e vet hyjnore, por nuk e pash nga pullazi i një shtëpie të re, që ishte ndërtuar afër saj. Mendova se do e shihja posa të afrohesha edhe pak, por kur u afrova pash një gërmadhë, e që ishte mbuluar me barë e therra.

Nisa t'i urreja të dyja, përnjëherë, pasi e kishin pushtuar odën e vjetër, ku vinin burra nga të gjitha anët e Kosovës... Ndala hapin dhe mu duk se e shihja babën këmbëkryq, në ballë të odës. Në të djathtë të tij shihja Raif Tashollin, një burrë i gjatë, e që ushtronte zejen e metaleve në bodrumin e shtëpisë. Mjeshtëria kryesore e tij ishte punimi i pushkëve. Raifi i kishte mbajtur 12 vjet burg në Mitrovicë të Sremit, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, sepse ishte për rrënimin e Jugosllavisë.

BURRI QË I DËGJONTE LAJMET E "RADIO LONDRËS"

Në të majtë të babait shihja Lif Hoxhën, burrin që dëgjonte lajmet e "Radio Londrës", e më tej, nga ai, shihja mikun e shtëpisë, xha Fetahun, babën e të cilit e

kishte vrarë hasmi.

Dhe, një grua e kishte marrë hakun e burrit, duke e kryer aktin e vrasjes, veshur me tesha të burrave.

Në anën e djathtë nga oxhaku shihja Hasanin e Malishevës dhe Nekiun e Prizrenit, e që, më vonë kuptova se ai ishte nga Vermica e kufirit me Shqipërinë.

Në odë e pash edhe patriotin e madh nga Cërnila e Ferizajt, Brahim Graincën, që kishte mbajtur burg për deklarim për bashkim me Shqipërinë, pikë ku edhe ishin ndarë me Fadil Hoxhën, me të cilin kishin qenë bashkëluftëtarë.

Dhe, secilin burrë që shihja, ishte histori në vete...

Bëj ca hapa në të majtë dhe nën gërmadhë shoh trapazanin e odës, e që ishte gjashtë metra i gjatë dhe i kishte tre metra gjerësi, brenda odës 100 metra katrorë. E, nën trapazan, babai i mbante drurët për stufën e odës...

Sillelme tutje dhe dal kah dera e odës, aty ku kanë shkelur pragun mijëra burra e dasmorë. Dhe, më shfaqen para sysh dasmat e gjithë mëhallës, e që bëheshin aty. Në hajatin e odës bëhej çaji dhe buka e dasmave.

PSE U MËSHONIN SHKELM DYERVE NJERËZIT E UDB-së?

Tutje dal tek dritarja e madhe prej druri, në të cilën kanë trokitur para mëngjesit shumë herë njerëzit e UDB-së, kur kërkonin të dinin se kush ishte në odë. Babait nuk i pëlqente kur dikush trokiste në dyert e oborrit dhe në xhamin e odës. Thoshte se nuk ishte shenjë e mirë që dikush u mëshonte dyerve të oborrit, pa e thirrur emrin e babait në derë. Dhe, u solla fund e krye odës së vjetër. Mu duk sikur burrat e mëdhenj janë nën gërmadhat e saj. Mu duk sikur fjalët e tyre dhe të bëmat i ruante oda, nëpër kohë...

Mu mbushën sytë lot kur m'u kujtuan gjithë ata burra, e që asnjëri prej tyre më nuk është gjallë. Trarët e një ane të odës ishin plandosur me maja në tokë, e bishti u qëndronte akoma në qiell.

Dhe, pas do viteve ajo do të shembej e tëra. Vetëm gurët e saj ende nuk kishin lëvizur, sepse trashësia ishte gjysmë metri. Andaj, në çast, mu mbushën sytë lot dhe thash se oda nuk qëndron në këmbë pa burrat e dheut! Sepse, nuk mund t'i ngushtojë për asgjë ata burra...

Sokol Murturi



Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri

Disa shqiptarë mustaqet vesh më vesh, punët përslesh!

*Për të dëshmuar bur-
rëri nuk mjafton vetëm
të jesh trim dhe të
vrasësh. Nuk mjaft-
ton të të frikësohen
të tjerët në mënyrë
jomeritore. Për të qenë
burrë nuk mjaftojnë
vetëm mustaqet deri te
veshët, as shqiponja
në ballë në plis, siç
është mbushur sheshi
i Prishtinës me ta!
Për të qenë burrë më
shumë duhet të falësh
dhe të tolerosh. Për
të qenë burrë lypset
sakrificë dhe mund.
Burrë të madh e të
mirë të bën vepra, e jo
veshja e as mustaqet...*

Linkoln, për të cilin do flas në këtë shkrim, nuk ishte ish-presidenti amerikan. Ai ishte një zezak skllav, që e shfrytëzonin mizorisht klasa e bardhë borgjeze në Amerikë, më 1865. E morën dhe e shitën bashkë me gruan dhe vajzën e tij, por tregu i shitjes e kishte ndarë familjen në dysh. Linkoln ishte shitur nga pronari për ta larë një borxh të majmë, meqë zezaku skllav kishte zotësi dhe inteligjencë të lartë, edhe pse nuk kishte shkollë. Klasa borgjeze, e që përbëhej nga raca e bardhë, nuk i lente të shkonin në shkollë, sepse ata mund ta lexonin Biblën dhe aty të demistifikonin



kamuflimin borgjez se zezakët i kishte lindur Zoti për të qenë robër të të bardhëve dhe se ata kishin ardhur në jetë për të bërë punë të rënda. Linkoln, që e shitën te një pasanik, mori detyrën të ndërtonte një barakë prej dërrase dhe tek e shikonte pronari i bëri vërejtje që dërrasat duhej të gozhdoheshin, duke mos u dalluar se ishin ngjitur njëra pranë tjetrës. Kur Linkoln e bëri barakën me dërrasa, erdhi padroni dhe, duke qenë i etur për ta rrahur, i vuri lakun në fyt për ta

varur dhe e la me litar në fyt një ditë e një natë, në majë të gishtërinjve të këmbëve, si dënim.

Ditëve të tjera ai qante vazhdimisht... Një ditë një i bardhë, shpirtmirë, e pyeti:

“Pse qan çdo ditë?”

Linkoln i tha:

“Do isha njeriu më i lumturi në botë sikur ta shihja gruan dhe fëmijën edhe një herë, sepse kanë kaluar më shumë se 20 vjet pa i parë!”

Njeriu i bardhë u ndie keq. Dhe, duke

ndjerë shpirtin lotues të zezakut, u interesua të dinte për familjen e tij. Gruan ia kishin vrarë, kurse vajzën e kishin martuar për një shërbëtor të zi, që ishte në grupin e të besuarve të bardhë.

I bardhi, kur mësoi për gjendjen e familjes së Linkolnit, nisi ta kërkonte atë dhe e gjeti duke punuar në arë, me skllevër të tjerë. Kur e gjet, e nxori nga puna dhe e qoi në shtëpi, ku edhe ndodhej vajza e tij me djalin e sapolindur. Por, para se ta qonte në shtëpi, Linkolin e kishte veshur me rroba të mira, për ta prezantuar para vajzës së tij tashmë grua.

Kur hyri zezaku në sallonin e shtëpisë së bukur, në këmbë qëndronin tri zonja, padroni i bardhë dhe një fëmijë i mbështjellë me batanije. Zezaku bëri ca hapa dhe u ndal, duke hequr borsalinën nga koka.

Vajza e tij, e që nuk e njhte, kishte pasur privilegjin të shërbente brenda shtëpive të pasanikëve dhe ajo klasë gëzonte më shumë respekt se skllevërit që jetonin në ara, kryesisht në fushat me pambuk. Zezaku i shikonte shërbëtoret, me shpresë se njëra nga to do jetë gruaja, por asnjëra nuk ngjasonte në gruan e tij... Dhe, kur pa se asnjëra nuk ishte gruaja e tij, nisën t'i bien lotët nga sytë...

Por, në çast iu ofrua vajza dhe i tha: "Ky fëmijë, i mbështjellë me batanije, është nipi yt!"

Dhe, në ato çaste, Linkolini filloi të qajë edhe me zë...

Mirëpo, për fat të mirë, nuk zgjati shumë e ra aparteidi dhe erdhi liria për zezakët në Amerikë. Ndërkohë, Linkolini ngriti padi ndaj borgjezëve për vdekjen e dhunshme të gruas së tij dhe në po atë vit doli para gjyqit me të akuzuarit. Padronët e bardhë u shpallën fajtorë për akt dhune ndaj gruas, por Linkolini hoqi dorë nga burgosja e tyre me nga 20 vjet burg. Ai i kërkoi gjyqit t'ua ndërronte vendbanimin racistëve gjakpirës, e që ia kishin zhdukur familjen dhe vazhdoi jetën i qetë, duke mos dashur të dënohej askush për familjen e tij!

Sidoqoftë, vazhdoi ta jetojë jetën me lot, por nuk pranoi të shkonin të bardhët në burg për vrasjen e gruas së tij... E, kësaj i thonë burrëri se jo mahi!

DISA TË FRIKËSOJNË ME MUSTAQET E GJATA!

Në popullin tonë mustaqet e gjatë dhe plisi janë konsideruar veprime të shenjta, që përfaqësojnë burrëri dhe dinjitet. Janë të paktë ata që i kanë mbajtur origjinal dhe janë të shumtë që kanë mbajtur dhe i mbajnë fals. Hyn një burrë te berberi, në Prishtinë. Sheh në pasqyrë një burrë teksa berberi ia rregullonte mustaqet e gjatë. Ai kishte jelek me qostek dhe pasqyronte burrin e fortë.

Edhe burri që hyri te berberi dukej njëjtë. Në çast, ai, duke menduar se mustaqet nuk hiqen për gazep të madh, i tha:

"Ti, bre burrë, a po i heqë mustaqet apo po i heq unë?"

"Po i heq unë!", ia ktheu ai.

Burri, në çast, shau mustaqet, duke ia kujtuar atij se nuk ia kishte zënë rrugën mustaku i tij, por se gjeti, më në fund, një burrë që e pranon të vërtetën...

E sot, te ne, në sheshin e Prishtinës, sheh "burra" me mustakë të gjatë e mjekra që nuk u vlejné për asgjë! Sheh burra me plis, në ballë shqiponjën! E, në fakt, janë burra falas, si ai që ka pranuar t'i heqë mustakët te berberi... Sido që të jetë, mustaku në të kaluarën tregonte njëfarë burrërie. Në fakt, kemi kaluar një shekull në luftë me Serbinë dhe, qoftë me fe e me realitet, mjekra e mustaku janë mbajtur për ta tmerruar armikun... E, pse mbahen sot?!

PSE SOT S'KA BURRËRI?

Nuk ka pasur kurrë më shumë ndarje të çifteve bashkëshortore në Kosovë se që ka sot! Kjo që sot po ndodh në Kosovë është një turp që nuk justifikohet me fjalë...

Mund të tingëllojë utopike e vërteta se në fshat kanë qarë i madh e i vogël kur është ndarë një çift...

"Pse dhe si erdhi te ndarja?", ka pyetur i madh e i vogël, duke qarë edhe nëse nuk e ka lidhur asgjë me çiftin familjarisht.

Sepse, ka pasur vlerë jeta, ka pasur solidaritet. Ka pasur fytyrë e burrëri... Nuk ke mundur t'ia përzësh askujt vajzën pasi të jesh fejuar.

Burrat dikur thoshin: "Gruaja dihet për çka lëshohet. Dhe, kur lëshohet – kërcet pushka!"

Kur ka ndodhur një ndarje është marrë burrëria me të dhe e kanë shtruar problemin në odë, duke pleqëruar burrat.

E, sot?!

Fill pasi fejohen e merr me vete i fejuari të fejuarën në shtëpi dhe e mbanë me muaj të tërë, kurse pas një zënke të vogël ndahen, kinse nuk qenkan për njëri-tjetrin!

Dhe, askush nuk merret me ta!

Pra, e mbanë të fejuarën sa të dojë dhe e lë kur ia do qejfi!

Keq, a?

A ka këtu burrëri?

Pa dyshim, jo. Sepse, po të kishte burrëri si dikur, nuk do të ndodhnin gjëra të tilla...

Dikur kanë pyetur nga i ka dajallarët djali a vajza, kurse sot as që pyet kush për këto gjëra!

Kush pyet sot nga i ka dajallarët vajza a djali?! Nuk pyet askush, sepse është krijuar vetëdija se mjafton të duhen ata dhe të shpallen burrë e grua...

AHMET DELIA U FLIJUA PËR FQINJIN NË PREKAZI!

Burrëri ka pasur dhe burrat janë flijuar për shumëçka që i ka takuar kodit moral dhe etikës njerëzore.

Në Prekaz të Drenicës kishin pas hyrë harambashët serbë dhe i kishin maltretuar e plaçkitur shqiptarët nëpër shtëpia. Kishin hyrë edhe në një shtëpi që ishte fqinje me shtëpinë e Ahmet Delisë, që i këndohet kënga.


Ahmet Delia i dëgjon britmat e fqinjave dhe i urdhëron djemtë t'i kapin sëpatat dhe ta mbrojnë fqinjin.

Kështu, kishte pësuar edhe vetë familja e Ahmet Delisë, duke u pajtuar me flijim, por duke mos u pajtuar me nënshtrim, edhe pse dhuna nuk kishte ndodhur në familjen e tij.

Burrëri kishte pas lënë edhe Selman Kadria, që e ka përmendoren në hyrje të fshatit Cërcë të Istogut, kur e kishte vrarë Miliç Kërstën, i cili i maltretonte banorët shqiptarë në fshat dhe në fshatrat përreth.

Ai kishte shtënë me manzere në Miliçin, duke e lënë të vdekur në vend dhe duke pësuar dhe vetë nga daja i tij, që kishte pasur marrëveshje me çetnikët në Istog.

Safet Krivaça



Jemi bërë popull që veç ankohemi e kritikojmë!

Nuk ka punë në Kosovë. Po e kuptoni papunësinë që e ka shkaktuar qeveria, nga të korruptuarit e shtetit. Të korruptuarit shumë ia kanë humbur vlerën popullit tonë, e që ka qenë emblemë e korrektësisë dhe besës.

Takova mikun tim që dikur pat nisur një biznes me produkte nga Shqipëria, vend i cili mori liberalizimin e vizave me kohë.

"Mbetëm pa viza, o mik!", i thash.

"Çka na duhen vizat neve, të Kosovës?!", ma ktheu ai.

"Po, si jo ore!", ia ktheva, "Ua shohim ndoshta ndonjëherë hajrin edhe ne...".

"Ne jo e Shqipëria po", ma ktheu ai.

"O mik, pse bash ata?".

"Ata dinë me sjellë e pështjellë e ne dimë vetëm të vjedhim!".

TI SHIKON MJEKU NË SY, A MENDJEN NUK E KA TE TI!

E, për të qenë edhe me keq, në Kosovë e tërë jeta e punës është e lidhur me administratën publike: shkon në sportel ta regjistrosh automjetin, zyrtari t'i

merr letrat e flet me dikë tjetër.

Pastaj, kthehet përsëri kah ti dhe të thotë pse ke ardhur...

Ose, shkon te mjeku dhe derisa të kontrollojnë, flet me tjetrin, e nuk e ka mendjen fare te ti...

Tjetër, shkon te stomatologu dhe, pasi të ulë në "karrigen e frikës", nis e flet me ndokënd në telefon... E, edhe nëse e ke gojën plot shkurmesa apo gjak, duhet ta mbash gojën hapur derisa ai e kryen punën e vet me telefon... Kur fillon të punojë në dhëmbin tënd, ia krisë muhabetit tek shan politikanët, shtetin...

Prandaj, jemi bërë popull i keq që vetëm shajmë e kritikojmë...

Dhe, vërtet, ashtu është: isha para pak ditësh në një ordinancë stomatologjike dhe mbeta gojëhapur, duke e dëgjuar mjekun me nam, që fliste kundër shqiptarëve dhe shtetit, kurse

e lavdëronte veten!

Ma kish mbushur gojën shkurmesa e vetë fliste... Dikur u mbusha dhe i thash: "Largomi shkurmesat se më janë kapur për qiellzë të gojës!".

Dhe, pasi m'i nxori, i thash: "Nuk mund të flisja me shkurmesa në gojë, por ti a nuk je shqiptar, a?!".

"Po-po, jam... por vetëm thash".

"O dosti jem, shihe veten! Prej kur jam këtu e ke ndal punën nja katër herë, duke folur me njerëz, e duke ua futur duart në gojë njerëzve pa u bërë punë fare, e tash po bën lavd, a?!".

Po të ishte ti në rregull do e mbaje rendin në ordinancën tënde e nuk do veproje në këtë mënyrë! Keq, o dosti jem, bile mos u shit francez!", i thash.

"Kam shumë terminë e nuk po di ku t'ia nis punës e rendit", më tha sa për t'u arsyetuar...

S. M.



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



Mos me kanë viagra, dreqi nuk më kish hëngër!

“Ne, shqiptarët, kemi rënë në hall me gratë dhe dashnoret, e kërkojmë ndihmë nga viagra. Sepse, po të mos ishin viagrat, thënë të drejtën, as dreqi s’na kish hëngër”, thotë Shaipi, i cili veç i ka kaluar të gjashtëdhjetat.

“Po më duket se më ka lëshuar takati dhe s’po mund t’i kryej “detyrat e shtëpisë” si duhet. Jo që kam shumë vjet, por veç gruas kurrë nuk kam qenë edhe pa dashnore. E, si duket “kroi” ka filluar të shteret.

Deri më vonë nuk kam marrë viagra, por kohëve të fundit po, sepse nuk po muj me bë punë si duhet.

Sepse, e di fort mirë se asnjë mashkull nuk dëshiron që gruaja e tij të mos ndihet mirë në seks, e sidomos dashnoret.

Andaj, shqyrr Zotit, viagrat po ndihmojnë, por kam lexuar dhe dëgjuar se ato duhet të përdoren në masë e jo të tejkalohen, sepse mund të ketë pasoja shëndetësore.

Në anën tjetër, mendoj se femrat e sotme nuk janë si ato të dikurshmet,

kur me mish e shpirt i janë përkushtuar fëmijëve dhe shtëpisë. Sot ato, më shumë se kurrë, u intereson të kënaqen, ta shijojnë jetën...

E, forca e energjia që sjell kënaqësi dikujt po i mungon, sepse ka burra që në të njëjtën kohë, krahas gruas, kanë edhe dashnore, së cilave nuk mund t’ua plotësojë qind për qind kënaqësi në seksuale.

E, kjo është arsyeja që të bëjnë përpjekje t’i gjejnë ku janë e ku s’janë viagrat për të kryer gjithmonë punë si duhet”, thotë Shaipi.

Ai tutje thekson se shumë femra i tradhtojnë burrat dhe të dashurit e tyre, sepse nuk janë në gjendje t’ua plotësojnë të gjitha nevojat e tyre seksuale dhe, në këtë mënyrë, detyrohen ta përmbushin vakuumin e tyre

seksual, duke tradhtuar të dashurit e tyre, sepse te ta nuk e kanë gjetur lumturinë e kërkuar seksuale.

“Kjo është e tmerrshme, për mendimin tim!”, thotë Shaipi dhe vazhdon: “Unë nuk e shikoj një lidhje, një dashuri a një martesë të konceptuar vetëm në kënaqësitë që t’i dhuron seksi.

Por, edhe pa kënaqësi në seks nuk ka marrëdhënie të rehatshme martesore.

Mirëpo, edhe një gjë duhet pasur parasysh: sot gjithçka ka ndryshuar dhe është modernizuar. E, për një modernizim të tillë, si duket, po na ndihmojnë edhe viagrat”.

Por, gjithmonë duhet të kemi kujdes që të mos tejkalohet me marrjen e tyre, sepse kanë pasoja të tjera të dëmshme shëndetësore...

B. Bajrami

tourist
CAMPING



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269336233 [/touristcamping_giovannisbeach](https://www.instagram.com/touristcamping_giovannisbeach)



Giovanni's Beach
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269825858 [/giovannis_beach_montenegro](https://www.instagram.com/giovannis_beach_montenegro)

Ti fjete mbrëmë me gruan, sonte po fle unë me të!

Ishin kapur ndërmjet veti dy vëllezër për një nuse në Prishtinë. Nusia kishte ardhur për vëllanë e madh, por vëllai i dytë kishte menduar se nusja është edhe për të... Kështu, edhe kishte plasur sherri në shtëpi...

Natë. Pas shumë vitesh u shtriva në oborrin e vjetër të shtëpisë. Gjinkallat këndonin këngën e verës, që jep qetësi e magji jetësore. Do të ishte nata e parë pas shumë vitesh që hëna ishte po ajo që kishte qenë në fëmijërinë time. Nuk e kisha shikuar mirë prej atëherë, por e dija se ajo më kishte parë shumë herë duke u orvatur me jetën... E shikoja hënën dhe mendja thellohej te ajo. Nisa t'i flas hënës dhe t'i them se si nuk është plakur fare. Se është po ajo që ke qenë që prej fëmijërisë sime...

Mbay mend kur hëna dilte mbi kodrën e sotme, të eksploatuar nga mihësit e pandërgjegjshëm, e unë shkoja në kodër ta prekja. Dhe, jo vetëm kaq, por doja edhe ta merrja me vete në shtëpi!

Jam shtrirë me shikimin kah hëna dhe e vështroj se si nuk e ka asnjë rrudhë, edhe pse për mua tashmë ajo është e moshuar. Është e vetmja që nuk është plakur, e vetmja që e kanë shikuar sa e sa njerëz para meje, por asnjëri nuk besoj të ketë rënë në shpinë për t'a shikuar pamjen si unë... Kam shumë nostalgji për atë që ka kaluar, e që nuk kthehet më. Dhe, kur themi të mos e kthejmë kokën nga e shkuara, bëjmë gabim, sepse e kaluara sjell kujtime, kurse e ardhmja shpresë...

Po në këto çaste dëgjoj këngën e doajenit Ismet Peja me një Burim Mehmetin, duke kënduar këngën "Dikur isha i ri". Nëse do kishte jetuar 100 vjet i madhi Ismet Peja, do t'i bashkonte edhe shumë zemra e do të këndonte edhe në shumë dasma të fëmijëve që tani sapo kanë hedhur hapat e parë në jetë.



SI IU NDËRRUA NUSJA NË NATËN E MARTESES?

Sikur e kaluara që sjell përvojën mbi të cilën bazohet njerëzimi, ashtu edhe gabimet janë pjesë jona e jetës. Në një mëhallë periferike të Prishtinës, në një rrugicë, dy vajza paskëshin pasur të bëheshin nuse në të njëjtën ditë. Shtëpitë e tyre ishin jo larg njëra-tjetrës. Kishin ardhur dasmorët e parë dhe, duke mos besuar se kishte edhe dasmë tjetër aty, me t'i parë pritësit e dasmorëve, ishin ndalur në vendin e pritjes. Sikur tani që nuk po njihen mirë miqtë, ishin përshëndetur dhe gratë ishin nisur për të shtëpia e nuses. Nëna e dhëndrit shihte se diçka nuk ishte si duhet, por duke respektuar besimin e burrave, nuk thoshte dot se nuk është shtëpia e nuses së tyre. Siç thotë populli: Zoti ia mbylli gojën!

Pas pak erdhi djali i saj, e që atë ditë bëhej dhëndër dhe, kur doli nusja, pa se nuk ishte ajo që ai do e martonte! Shkurt e shqip, pa se ishin gabim... Dhe, për të mos e zgjatur shumë, u kërkuu falje e falje për gabimin. U dha edhe hallalli për gabimin e bërë dhe u mor vesh se pak më poshtë ishin burrat tjerë që do të prisnin dasmorët.

A KA NJERI QË DI SI DO TË JETË E ARDHMJA?

Po e shkruaja për masakrën e Gallapit, më 1999, menjëherë pas mbarimit zyrtar të luftës në Kosovë, kur kreu i Redaksisë më në zë në Kosovë, i "Kosovares", më tha të vazhdoja të shkruaja për ngjarjet e hidhura gjatë kohës së luftës.

Një njeri në terren më tha të mos merrem me të kaluarën, por të shkruaj për të ardhmen...

"Ku t'i marr shënimet e të ardhmes, o njeri?

A ka zyrë të së ardhmes, kur ende i kemi kufomat mbi tokë?", i thash.

Ai kërkonte të shkruaja për të ardhmen, duke hequr dorë nga e kaluara! Kjo përputhej pikërisht me rekomandimet e ushtarakëve të KFOR-it në Kosovë, që rekomandonin t'i referohemi të ardhmes.

Dhe, duke qenë diku si në mes, kuptova dy gjëra të rëndësishme: Ata që rekomandonin të mos shkruajmë për të kaluarën ishin miq të Serbisë, ndërsa ata që porosin të shkruajmë sa më shumë për krimet serbe në Kosovë ishin miq të Kosovës.

Dhe, duke qenë mes këtyre dy gjërave, kisha fituar përvojën më të mirë që ta testoja shpirtin e vërtetë të çdo njeriu.

U LINDA E U PLAKA NË PRISHTINËN ME BALTË!

Më kujtohen fjalët e Sabri Fajzullahut, këngëtarit tonë të njohur, kur kohë më parë tha në një emisionin se u lind në Prishtinën me baltë, u rrit në Prishtinën me baltë e u plak në Prishtinën me baltë, tash edhe me pluhur!

Prandaj, Prishtina është një nuse e gabuar e Kosovës, së cilës mund t'ia futë dorën kush të dojë, me apo pa qëllim, sepse është nuse e të gjithëve...

Kjo puna e nuses për krahasim me Prishtinën dhe qeverisjen mund të ilustruhet pak më mirë me një shembull, batutë: Ishte martuar një njeri në Prishtinë. Nuk po ja përmend etnitetin, sepse na qesin telashe. E sjellin nusen në shtëpi. Në natën e parë hyn dhëndri, e në natën e dytë vëllai i dytë e kapë për fyti dhëndrin.

"Çka u bë?", i thotë ai.

"Ti ishe mbrëmë me nusen, sonte po shkoj unë te ajo!", ia kthen ai, duke menduar se nusja ishte për të gjithë vëllezërit!

**Në vendndodhjen
më të mirë të
qytetit...**



MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A do më pranojnë në shtëpi?

Përsëndetje, jam një vajzë 21-vjeçare, jetoj jashtë Kosovës. E dua një person që nuk është shqiptar dhe kam lëshuar shtëpinë për të, duke bashkëjetuar qe disa muaj me të.

Unë po shoh tani se ai çdo ditë e më shumë po e humb interesimin për mua dhe po mundem ta marrë me mend se ai një ditë do të heqë dorë prej meje...

Jam në mendime të kthehem në shtëpi. Kam kontaktuar me nënën dhe kam kërkuar mendimin e saj nëse do më pranojnë në shtëpi, por ajo nuk më ka premtuar se mund të kthehem që të jetoj si më parë në shtëpi.

Babai, vëllezërit e axhallarët kanë luftuar shumë të mos më lënë të lidhem me atë person dhe sikur kanë hequr dorë tani prej meje. Nëna më tha se na e ke nxirë fytyrën dhe më nuk ke vend në shtëpi.

Çka më preferoni ju, e nderuara magjistare: A do të më pranoj familja dhe çka duhet të bëj unë që të kthehem në familjen time?

"Pa shifër"

Përgjigje:

Dy vite ka luftuar familja jote për të mos u lidhur ti me atë person që nuk i përshtatet natyrës së familjes suaj. Prindërit kanë pasur tepër mërzi dhe gjërat kanë shkuar deri në polici... Të gjitha ato janë të kaluara dhe

pyetja është: Çka tutje?

E mira e gjithë kësaj të keqe është se ti nuk je shtatzënë dhe ka mundësi të ndodhë riakomodimi yt në familje.

To duhet të jesh e singertë dhe të flasësh me nënën dhe babanë tënd, dy personat më të afërt gjenetik për ty. Ata mund ta shtrijnë ndikimin te pjesa tjetër e familjes që ti të pranohesh në familje.

Unë shoh se kjo mundësi ekziston, por ti duhet ta mbash premtimin, sepse, në të kundërtën, mund të ndezësh probleme të reja, që mund t'i kalojnë vijat e kuqe të tolerancës. Kërko takim me prindërit dhe u kërko falje!

Çka do të ndodhë me djalin?

Jam një nënë, 50-vjeçare, kam problem me renë. Ajo i takon një familjeje të pasur, e ne nuk i kishim mundësitë t'i përmbushnim dëshirat e saj dhe u munduam t'ia thyenim egon e ta përshtatnim me gjendjen tonë familjare... Djali e kuptonte se qëllimi ynë ishte tjetër, por ai nuk e la dhe doli nga shtëpia me nusen e vet. A do të vijnë në shtëpi djali dhe nusja përsëri?

"Nëna"

Përgjigje:

Keni vepruar gabimisht. Ju e keni pranuar nusen me gjithë ato virtyte dhe të meta që i kishte, por, mbi të gjitha, për te ka vendosur djali juaj.

E keni pasur çdo gjë të ditur para-prakisht, por keni jetuar me shpresë se ata do të ndahen...

Ju keni mundu ta keni mbështetjen e familjes së nuses për çdo gjë që nuk keni pasur mundësi ta plotësoni vet, por e keni humbur rastin.

Këshilla ime është: Të mos ndërhyjni më në jetën e tyre! Lëreni të jetojnë jetën e vet!

Nëse ata e duan njëri-tjetrin, do ia dalin të vazhdojnë jetën, edhe pse nuk kanë pasurinë e botës.

Sepse, dashuria e vërtetë e mund edhe skamjen...

Diçka po troket pas shtëpisë!

Jemi një familje nga rrethi i Ferizajt, jetojmë me nënën, vëlla nuk kemi.

Ka disa net që dëgjojmë një kërcitje pas shtëpisë sonë dhe kjo po na shqetëson shumë. Aq më tepër kur pas shtëpisë ka qenë një bunar, që e ka mbushur babai me pleh dhe gurë dhe ne po dys-hojmë se prej aty po vijnë krismat. Çka të bëjmë, magjistare e dashur?

"Frika"

Përgjigje:

Nuk është e vërtetë se ju vjen ndonjë krismë nga bunari. Përgjigjen në këtë problem duhet ta jep motra e dytë...

Trokitjet janë sinjale për takim.

Motra e dytë, Z., e di sigurt se kush është. Ajo e di se kush qëndron pas trokitjeve të shtëpisë...

A kam probleme me magji?

Zonja magjistare, jam një grua, 42-vjeçare, jetoj në rrethin e Gjilanit. I kam dy fëmijë dhe burrin. E kam jetën e mirë dhe nuk e kam vërtet asnjë problem familjar. Por, e kam një problem tjetër, e që e prish lumturinë time.

Në fakt, ka kohë që nuk po mund të fle natën. Ka kohë që nuk jam e qetë dhe se brenda meje ndjej se ka diçka të brendshme, që do të dalw në sipërfaqe të jashtme, e nuk e di çka është ajo...

Ka net kur vjen një plakë dhe më ndrydhë në gjoks! Herën e fundit aq shumë më ndrydhi sa mezi shpëtova pa vdekur në gjumë... Çka sheh ti, motër e dashur, te unë dhe a do më kaloj ky problem? A kam magji?

“E frikësuar”

Përgjigje:

Realisht, magjitë ekzistojnë. Ekziston edhe mësyshi, siç thuhet në gjuhën popullore.

Magjitë janë të dëshmuara dhe kanë ekzistuar qyshkur ekziston njeriu, prandaj nuk është pa domethënie që sot në botë ka qindra mijëra filma për magjitë dhe magjistarët, ndërsa fetarisht një i tillë ka qenë edhe Hazreti Musa, i cili kishte aftësi ta shpëtojë popullin e vet përmes skenave të magjive që sjellin shpëtim.

Krejt kjo perceptohet në dy mënyra: Besimtarët besojnë në magji, por edhe pabesimtarët mjaft shumë, ndërsa asi që nuk besojnë në magji ka fare pak.

Ka shumë fakte që një fëmijë, pasi mund të jetë parë nga syri i keq, te ai janë shfaqur problemet që nuk janë të natyrës mjekësore.

Ka raste që kur një vajzë bëhet nuse, kalon një sfidë të mendjes së turbulluar, që nuk ka lidhje me mjekësi, por me magji!

Andaj, nuk është çudi që shërimet ndër kohë nuk i kanë bërë vetëm mjekët, por edhe të tjerët, që kanë qasje gjenialiteti mendor e që, fatbardhësisht, nuk janë të pakët.

Kam frikë të rri vetëm!

Përsëendetje, jam 65-vjeçare, i kam katër fëmijë, janë jashtë, konkretisht në Zvicër.

Burri më ka vdekur para tre vjetësh dhe kam mbetur e vetmuar.

Dua të jetoj dhe të vdes këtu ku më la burri im, me të cilin i lindëm dhe rritëm fëmijët tanë e ku krijuam pasurinë tonë.

Po mundohen disa mbesa të rrinë me mua, por edhe ato punët e veta i kanë e nuk po dua të jem

pengesë për askënd.

Zonjë, ka tre muaj që e kam një frikë në momente të caktuara. Kur më shkon mendja te disa gjëra të këqija, ndihem se po kaloj në frikë. Si ta kaloj këtë gjendje, zonjë e nderuar?

“Pa shifër”

Përgjigje:

Të përmendurit e Allahut, xh. h., është prej rëndësisë së parë dhe themelore për të qenë njeri që do jetojë pa frikë.

E kam fjalën në pikëpamjen e moshës, kur njeriu afrohet më afër viteve të moshuara e që e mendon më shumë vdekjen.

Dhe, duke qenë e lidhur me Zotin e madhërishtëm, njeriu përjashton nga shpirti frikën, xhelozinë, haramin dhe ofron të mirat që janë pjesë përbërëse e parajsës.

Muhamedi, a. s., ka thënë:

“A doni t’ju tregoj për veprën më të mirë, më të dashur tek Allahu, me të cilën fiton shpërblimet më të larta tek Ai...”

Dhe, kur ata që e dëgjonin i thanë po, Muhamedi, a. s., tha: “Të përmendurit e Allahut” (Dhikri 1).

Pra, në të dy skajet e ditës të bësh namaz, sepse duke qenë në këtë pozitë përfiton lidhjen më të ndritshme me Allahun, xh. h.

E, duke bërë namaz përfiton edhe sigurinë dhe vetëbesimin. Dhe, kur i ke këto elemente, e kupton se njeriu, ashtu sikur vjen si një dhuratë në botën e dritës, dorëzohet në ditën e fundit të jetës tek Ai që e solli në jetë! Pra, të përmendurit e Allahut është lidhje me të vërtetën dhe besimin dhe këtu fisnikërohet shpirti me elementin që kohës sonë po i mungon në masë të madhe.

Sepse, për të qenë mysliman i vërtetë duhen përmbushur shtyllat islame dhe secila shtyllë i ka elementet e veta, të cilat përbëjnë personalitetin. Për ata që e duan Zotin e madhërishtëm, të gjitha obligimet e tilla janë të lehta.

Për ata që janë të drejtë nuk ka më lehtë se të përmbahesh në këto

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

pikëpamje.

Për ata që nuk e duan haramin, nuk ka më lehtë se ta duash tënden dhe mos ta pranosh të huajën. E, kështu me radhë...

Vajza nuk po pranon martesë, është përkushtuar vetëm në shkollim!

Jam një nënë e dy vajzave dhe dy djemve. Kam probleme me vajzën e madhe, e cila po synon të doktorojë. Andaj, as që do t’ia përmendim martesën!

Me burrin po kemi çdo ditë biseda për t’ia gjetur dikë vajzës që të martohet, por ajo s’do!

Na thotë: Kush do të martohet e ka rrugën hapur, e mua më intereson shkolla!

Jemi në hall, motër e nderuar! Mos e ka fatin e mbyllur?

“Prindërit e brengosur”

Përgjigje:

Vajza nuk e ka fatin e mbyllur dhe mos e pengoni të doktorojë. Burrin e gjen a arritjen shkencore nuk e gjen dot.

Prindërit tanë nuk u intereson më shumë se vajzës a djalit t’i gjejnë partner për martesë, sepse është e tillë vetëdija kolektive se fëmijën duhet ta martojnë prindërit, patjetër, që ata të ndihen rehat!

E, kjo është plotësisht e gabuar.

Në vend se t’i thuhet vajzës - urdhëro doktoro dhe ne të përkrahim, prindërit tanë mundohen që atë ta bindin të heqë dorë prej të gjithave dhe të martohet!

Martese gjen, por jo edhe doktorturë...

Andaj, përkrahni të doktorojë, sepse kjo është primare për vajzën tuaj, së cilës i ecë puna mbarë...



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



SHERWOOD

Resorts and Hotels

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

www.sherwoodhotels.com.tr
+90 444 88 07